

Armët e tepërta të në Evropën Jug-Lindore

Politikat dhe praktikat shtetërore

Siguria fizike dhe menaxhimi i duhur i inventarëve kombëtarë dhe rezervave të tepërta të armëve janë thelbësore për minimizimin e efekteve të mundshme të rrezikshme mbi popullsinë dhe mjedisin rreth depove të armëve.

Ka shumë faktorë që çojnë në krijimin e rezervave të armëve të vogla¹ dhe municioneve, që tejkalojnë nevojat e një shteti. Disa nga këta faktorë janë ndryshimet në lidhje me sigurinë, pakësimi i forcave të sigurisë, programet e prokurimit, dhe shtimi i konfiskimit të armëve të paligjshme apo të paautorizuara. E gjithë kjo tepricë duhet trajtuar në mënyrën e duhur.

Shtete të ndryshme të Evropës Juglindore mund të kenë mënyra të ndryshme të përcaktimit të nevojave për armë, por të gjithë pohojnë se kanë tepricë armësh të vogla dhe municionesh. Ka tre shkaqe kryesore për këtë tepricë. Së pari, shumë vende të ish-Jugosllavisë² grumbulluan armë në mënyrë masive gjatë luftërave civile në vitet 90 që shkatërruan rajonin. Së dyti, që nga ajo kohë tensionet dhe frika nga rreziqet janë ulur dhe si rrjedhojë është reduktuar numri i personelit të sigurisë shtetërore. Dhe së treti, shumë vende të rajonit janë bashkuar me Organizatën e Traktatit të Atlantikut Verior (NATO) dhe aktualisht po kalojnë nga kërkesat e Traktatit të Varshavës në lidhje me armatimin në ato të NATO-s. Duke pranuar nevojën për të menaxhuar këtë tepricë armësh, vendet e rajonit janë përpjekur të marrin pjesë në pro-

grame bashkëpunimi me vende të tjera. Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë mbështetur Iniciativën për Përqasje Rajonale të Reduktimit të Tepricave (PRRT) duke asistuar nëntë vende të Evropës Juglindore³ të menaxhojnë sa më mirë tepricat e tyre, madje edhe nëpërmjet shkatërrimit, kur është e përshtatshme⁴.

Kjo Përmbledhje e Shkurtër paraqet një profil të politikave dhe procedurave të zbatuara nga vendet e Evropës Juglindore që janë pjesë e Iniciativës PRRT në lidhje me trajtimin e tepricave të armëve të vogla dhe municioneve. Pjesa e parë shqyrton kuadrin e politikave ndërkombëtare dhe rajonale për trajtimin e tepricave dhe më pas politikave që mund të ndiqen. Pjesa e dytë jep një pasqyrë të mënyrës se si

ka vepruar secili vend me rezervat e tepërta kombëtare⁵. Pjesa e tretë, fokusohet te qasja e ndërmarrë nga këto vende në lidhje me armët dhe municionet që u janë konfiskuar civilëve (kjo pjesë nuk mbulon atë sasi armësh të mbledhur nëpërmjet programeve të grumbullimit të armëve, të sponsorizuara në nivel kombëtar e ndërkombëtar).

Gjetjet kryesore të këtij studimi janë:

- Shkatërrimi i tepricave të armëve dhe municioneve është vetëm një nga opsionet e mundshme dhe jo më i favorizuar në vendet e Evropës Juglindore.
- Shitja është metoda më e preferuar për tepricën e armëve të vogla në rajon.





Mbetje predhash 82mm në pritje për autoklavë, Shqipëria © NAMSA

- Prioritet i është dhënë shkatërrimit të municioneve të paqëndrueshme dhe në gjendje kritike, si dhe armëve të ndaluara, të papërdorshme, apo me defekt, të cilat janë sekuestruar, konfiskuar apo grumbulluar.
- Të gjitha vendet, me përjashtim të Maqedonisë dhe Serbisë, ua dhurojnë tepricat shtetërore shteteve të huaja.
- Bosnja dhe Hercegovina duhet të bëjë të paktën dy përpjeke për të shitur armët dhe municionet e tepërta nëpërmjet një procesi tenderimi; Kroacia mund të ofrojë një çmim më të ulët ose ta dhurojë tepricën e vet në rast se nuk mund ta shesë nëpërmjet një procesi tenderimi.
- Maqedonia dhe Rumania mund t'ua rishpërndajnë tepricat shtetërore ministrive apo organeve të tjera kombëtare, të cilave u lejohet me ligj të mbajnë armë.

- Shkatërrimi i armëve dhe municioneve të sekuestruara dhe konfiskuara është e vetmja mënyrë asgjësimi në Bosnje-Hercegovinë dhe Serbi.
- Bullgaria, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi dhe Sllovenia i shpërndajnë armët e sekuestruara dhe të konfiskuara midis ministrive të tyre.

Asgjësimi i armëve dhe municioneve të tepërta

Asgjësimi dhe shkatërrimi i tepricave të armëve të vogla dhe të lehta, dhe municioneve të tyre, nuk kufizohet apo orientohet nga një traktat ligjor detyrues, pavarësisht se ka shumë instrumente dhe marrëveshje ndërkombëtare dhe rajonale që parashikojnë disa parime në lidhje me këto çështje. Shumë organizata rajonale dhe shtete donatore inkurajojnë, dhe

shpesh mbështesin idenë e shkatërrimit. Megjithatë, shkatërrimi dhe asgjësimi i materialeve të tepërta varet kryesisht nga vendimet njëpalëshe të marra nga qeveritë (Karp, 2008, fq. 78). Qeveritë identifikojnë dhe përcaktojnë tepricat e tyre sipas kriterëve të përcaktuara nga vetë ato; nuk ka konsensus në lidhje me çfarë përbën tepricë. Në këtë botim përdoret përkufizimi i termit 'tepricë' i përdorur nga Paneli i Ekspertëve Qeveritarë të Kombeve të Bashkuara mbi Armët e Vogla: *armë të vogla dhe të lehta të përdorshme dhe të papërdorshme, të mbajtura rezervë nga forcat policore dhe ushtarake, dhe armët e paligjshme të sekuestruara nga këto forca, por që nuk u nevojiten më* (UNGA, 1997, paragraf. 80(e), n. 15).⁶

Kjo pjesë paraqet një përmbledhje të kornizave dhe instrumenteve më të rëndësishme ndërkombëtare dhe rajonale mbi shkatërrimin e tepricave, që aplikohen në vendet e Evropës

Juglindore. Paraqiten gjithashtu edhe disa nga udhëzimet strategjike dhe operacionale në lidhje me eliminimin e tepricave të armëve dhe municioneve. Së bashku, përbëjnë një set të dobishëm praktikash më të mira për të gjithë aktorët. Së fundi, kjo pjesë ilustron opsionet e mundshme të politikave praktike për asgjësimin e rezervave të tepërta.

Udhëzimet dhe praktikat më të mira

Tashmë njihen mirë rreziqet e lidhura me armët dhe municionet e tepërta, si dhe përfitimet nga menaxhimi i duhur i tyre. Ka më shumë se dhjetë vjet që organizma ndërkombëtarë dhe rajonalë trajtojnë këto çështje shqetësuese. Siç ilustrohet më poshtë, shumica e udhëzimeve janë thjesht rekomandime; vetëm një kornizë – Protokollin i i Kombeve të Bashkuara për Armët e Zjarrit – përshkruan veprime të zbatueshme me ligj.

Kornizat ndërkombëtare

Me përjashtim të Marrëveshjes së Wassenaar-it, të gjitha referencat ndërkombëtare të renditura në këtë seksion theksojnë shkatërrimin e tepricës së armëve të vogla dhe të lehta si një metodë e përgjegjshme asgjësimi.

Protokollin i Kombeve të Bashkuara për Armët e Zjarrit është një shembull i rrallë i një marrëveshjeje ligjore detyruese për armët e vogla dhe të lehta, zbatimi i së cilës mund të bëhet i detyrueshëm në parim nga e drejta ndërkombëtare. Ky protokoll përfshin edhe detyrimin për të shkatërruar armët e zjarrit të prodhuara dhe trafikuar në mënyrë të paligjshme, pjesët dhe komponentët përbërës të tyre, dhe municionet ‘përveç rasteve kur autorizohet zyrtarisht një metodë tjetër asgjësimi’ (UNGA - Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, 2001, neni 6). Një nga kufizimet e Protokollit të Armëve të Zjarrit të Kombeve të Bashkuara është fokusimi i tij ekskluzivisht në armët e zjarrit të prodhuara dhe trafikuar ilegalisht.

Për pjesën tjetër të armëve dhe municioneve të tepërta nuk ka asnjë marrëveshje ligjërish të detyrueshme. Organizma dhe iniciativa të tjera ndërkombëtare u japin vetëm rekomandime shteteve të tyre anëtare.

Për shembull, *Raporti i Panelit të Ekspertëve Qeveritarë të Kombeve të Bashkuara mbi Armët e Vogla*, i vitit 1997 dhe *Raporti i Panelit të Grupit të Ekspertëve Qeveritarë të Kombeve të Bashkuara mbi Armët e Vogla* i vitit 1999, tregojnë qartë preferencën për asgjësimin e armëve dhe municioneve të tepërta nëpërmjet shkatërrimit të tyre. Këto raporte rekomandojnë që shtetet të marrin masat e duhura për të siguruar marrjen e masave të përshtatshme të sigurisë për parandalimin e humbjes së armëve që duhet të përdoren nga forcat policore dhe ushtarake, si dhe për grumbullimin dhe shkatërrimin e të gjitha armëve të vogla dhe të lehta të tepërta (UNGA, 1997, paragrafi 80; 1999, paragrafi 72).

Në të njëjtën mënyrë, në Rezolutën e Kombeve të Bashkuara për Çarmatimin e Përgjithshëm dhe të Plotë, Asambleja e Përgjithshme mirëpret ‘masat praktike të marra nga Shtetet Anëtare për të shkatërruar armët e tepërta dhe armët e konfiskuara apo grumbulluara, në përputhje me rekomandimet e Sekretarit të Përgjithshëm në raportet e tij mbi armët e vogla’ (UNGA, 2000, pjesa R, parathënia). Në mënyrë më specifike, inkurajon Shtetet Anëtare, të cilat kanë mundësi të veprojnë në këtë mënyrë, që të marrin masat e duhura kombëtare për të shkatërruar tepricën e armëve të vogla dhe të lehta, si dhe armët e vogla dhe të lehta të konfiskuara apo grumbulluar’ (neni 3).

Programi i Kombeve të Bashkuara i Veprimeve për të Parandaluar, Luftuar dhe Asgjësuar Tregtinë e Paligjshme të Armëve të Vogla dhe të Lehta në të Gjitha Aspektet (Programi) është instrumenti më gjithëpërfshirës për armët e vogla dhe të lehta në nivel global. Në nivel kombëtar, Programi i inkurajon shtetet që ‘të sigurojnë

shkatërrimin e të gjitha armëve të vogla dhe të lehta të konfiskuara, sekuestruara, apo grumbulluara sipas çdo detyrimi ligjor në lidhje me përgatitjen e procedimeve penale, përveç rasteve kur autorizohet zyrtarisht një mënyrë tjetër rregullimi apo përdorimi’ (Kombet e Bashkuara, 2001, pjesa II, paragrafi 16). Gjithashtu, shtetet pjesëmarrëse angazhohen të rishikojnë rregullisht rezervat e armëve të vogla dhe të lehta dhe të:

sigurojnë që rezervat e deklaruara nga autoritetet kombëtare kompetente si të tepërta në krahasim me kërkesat, të identifikohen qartë, si dhe që krijohen dhe zbatohen programe për asgjësimin e përgjegjshëm të tyre – duke preferuar metodën e shkatërrimit (paragrafi 18).

Edhe pse thekson rëndësinë e një asgjësimi të përgjegjshëm, Programi tregon qartë se shkatërrimi është mënyra e preferuar. Në pjesën e tretë, Programi referon qartë që shtetet duhet të sigurojnë asistencë për shkatërrimin apo mënyrat e tjera të asgjësimit të tepricave, dhe duhet të ndihmojnë në ngritjen e kapaciteteve për shkatërrimin e tyre (Kombet e Bashkuara, 2001, pjesa III, paragrafi 6).

Instrumenti Ndërkombëtar më i përqendruar që përdoret për t’u dhënë mundësi shteteve të identifikojnë dhe gjurmojnë armët e vogla dhe të lehta të paligjshme në kohë dhe mënyrën e duhur nuk fokusohet në gamën e plotë të armëve të vogla dhe municioneve të tepërta, por vetëm në armët e vogla dhe të lehta të paligjshme. Ky instrument u bën thirrje shteteve që të shënojnë dhe regjistrojnë, ose të shkatërrojnë, sa më shpejt dhe në mënyrë unike, armët e vogla dhe të lehta të paligjshme që ndodhen në territorin e tyre (UNGA, 2005b, paragrafi 9).

Marrëveshja e Wassenaar-it për Kontrollin e Eksportit të Armëve Konvencionale dhe Mallrave e Teknologjive që përdoren për dy funksione të ndryshme, e cila filloi të zbatohet në vitin 1996, është mar-

rëveshja⁷ e parë shumëpalëshe në nivel global për kontrollin e eksportit të armëve konvencionale dhe mallrave e teknologjive sensitive që përdoren për dy funksione të ndryshme. Kjo marrëveshje përcakton praktikën më të mira për transferimin e armëve dhe municioneve dhe fokusohet në ndikimin e mundshëm të tyre mbi stabilitetin rajonal dhe ndërkombëtar. Ajo përfshin gjithashtu edhe praktikën më të mira për shitjen e mallrave të çmilitarizuara, edhe pse nuk jep asnjë udhëzim për shkatërrimin e armëve dhe municioneve të tepërta⁸. Në vitin 2000, në Seancën Plenare të Marrëveshjes së Wassenaar-it, u ra dakord për disa praktika të mira jo detyruese për kontrollin e eksportit të pajisjeve ushtarake të tepërta dhe të çmilitarizuara (WA, 2010, fq. 45, 82).

Ka disa rezoluta të Asamblesë së Përgjithshme që trajtojnë ose prekin çështjet e tepërta të armëve dhe municioneve dhe shkatërrimit të tyre. Në këtë kontekst vlejnë për t'u theksuar dy rezolutat mbi 'Problemet e lindura nga grumbullimi i rezervave të tepërta të municioneve konvencionale'. Të dyja këto rezoluta bëjnë thirrje për marrjen e masave për të luftuar devijimin dhe rrezikun e shpërthimeve si rezultat i menaxhimit jo të duhur, dhe nga rezervat e pasiguruara. Këto masa përfshijnë përmirësimin e menaxhimit të rezervave dhe asgjësimin e tepërta, si dhe masa për të trajtuar trafikimin e paligjshëm (UNGA, 2005a; 2006, parag. 3-4). Në paragrafët e dytë, këto rezoluta u bëjnë thirrje të gjitha shteteve të interesuara që të përcaktojnë mënyrat e shkatërrimit të rezervave të tepërta dhe të sigurojnë mundësinë për të treguar nëse nevojitet asistencë e jashtme për të eliminuar këtë rrezik.

Kornizat rajonale

Kornizat e mëposhtme rajonale njohin rëndësinë e asgjësimit të shpejtë dhe efektiv të armëve dhe municioneve të tepërta. Ato theksojnë se shkatërrimi është metoda e preferuar e asgjësimit të këtyre tepërta⁹. *Dokumenti mbi*

Armët e Vogla dhe të Lehta i vitit 2000, i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) përcakton normat, parimet dhe masat me qëllim mbulimin e të gjitha aspekteve të ciklit të jetës së një arme. Pas titullit 'shkatërrim dhe çaktivizim' shtetet pjesëmarrëse bien dakord 'që metoda e preferuar për asgjësimin e armëve të vogla është shkatërrimi [...] dhe që çdo sasi armësh të vogla përtej nevojave kombëtare, mundësisht, duhen shkatërruar'. Për më tepër, sipas këtij dokumenti armët e trafikuar ilegalisht dhe të sekuestruara nga autoritetet, duhen shkatërruar (OSBE, 2000, pjesa IV (C), parag. 1-2).

Dokumenti i OSBE-së mbi Rezervat e Municioneve Konvencionale i vitit 2003 plotëson *Dokumentin e OSBE-së mbi Armët e Vogla dhe të Lehta* të vitit 2000. Ky dokument bën një zbatim të detajuar të çështjeve dhe masave në lidhje me menaxhimin e municioneve (të tepërta) konvencionale – duke përfshirë edhe municionet për armët e vogla dhe të lehta (OSBE, 2003a, neni 17 (i)). Dokumenti përshkruan hollësisht një kuadër të përgjithshëm, procedurat dhe mekanizmat ndihmëse të shteteve të tjera pjesëmarrëse të OSBE-së për të siguruar kushte të sigurtë magazinimi të municioneve kombëtare dhe shkatërrimin e rezervave të tepërta. Në këtë aspekt, u kërkon shteteve pjesëmarrëse të sigurojnë informacion për shtetet që e kërkojnë atë, në lidhje me 'planin për shkatërrimin/përmirësimin e menaxhimit të rezervave' (neni 27(vi)). Dokumenti nuk sugjeron metoda të asgjësimit të tepërta. Megjithatë, dispozitat përfundimtare të tij tregojnë që OSBE-ja do të 'marrë në konsideratë zhvillimin e udhëzimeve teknike për një "praktikë më të mirë" dhe procedurave për shkatërrimin e municioneve konvencionale' (neni 38). Ky udhëzues u publikua në vitin 2008 (OSBE, 2008).

Parimet e OSBE-së për Kontrollin e Eksporteve të Sistemeve të Raketave Tokë-Ajër (MANPADS) përfshijnë një sërë parimesh për kontrollin e eksportit

të këtyre raketave. Përveç një sërë mekanizmesh kontrolli për transfertat ndërkombëtare dhe ritransferimin e raketave tokë-ajër, qeveritë eksportuese duhet të sigurohen për marrjen e masave të duhura nga qeveritë pritëse për 'magazinimin, trajtimin, transportin, përdorimin e raketave tokë-ajër, dhe asgjësimin apo shkatërrimin e rezervave të tepërta, në mënyrë që të parandalojnë tepërcat dhe përdorimin e paautorizuar' (OSBE, 2004, parag. 2.7).

Veprimi i Përbashkët i 12 korrikut 2002 i Këshillit të Bashkimit Evropian mbi kontributin e BE-së në luftimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së pastabilizuar të armëve të vogla dhe të lehta, identifikon qartë armët e vogla dhe të lehta, si dhe municionet e tyre, si një çështje shqetësuese, dhe pranon rëndësinë e magazinimit të sigurt dhe shkatërrimit të shpejtë dhe efektiv të tyre. Parimet dhe masat e caktuara për reduktimin e grumbullimeve ekzistuese të armëve të vogla dhe municioneve të tyre parashikojnë asistencë për vendet që kërkojnë mbështetje për të 'kontrolluar apo eliminuar armët e vogla dhe municionet e tepërta që ndodhen në territorin e tyre', dhe për të 'hequr në mënyrë efektive armët e vogla të tepërta duke i ruajtur në vende të sigurtë dhe për t'i shkatërruar shpejt dhe në mënyrë efektive, bashkë me municionet e tyre – po të ishte e mundur nën mbikëqyrjen ndërkombëtare' (Këshilli i BE-së, 2002, neni 4(a), 4(c)).

Plani Rajonal për Zbatimin e Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore ka për qëllim të luftojë shtimin e pakontrolluar të numrit të armëve të vogla dhe të lehta. Plani përfshin edhe një seksion mbi shkatërrimin e armëve të vogla dhe të lehta. Gjithashtu, ky plan pohon që nën termin 'masa specifike' duhet përfshirë 'zbatimin e programeve të shkatërrimit të armëve, municioneve dhe eksplozivëve të tepërt, të mbledhura, në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare, dhe duke marrë parasysh problemet mjedisore'

si pjesë e programeve të shkatërrimit (SSEE, 2006, pjesa C).

Udhëzimet strategjike dhe operacionale

Shkatërrimi i armëve dhe municioneve është një detyrë tepër e specializuar që kërkon marrjen në konsideratë të shumë faktorëve. Një sërë dokumentesh dhe udhëzuesish të renditura në këtë seksion ofrojnë udhëzime mbi aspektet praktike¹⁰.

Raporti mbi Metodën e Shkatërrimit të Armëve të Vogla dhe të Lehta, Municioneve dhe Eksplozivëve, i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara thotë “Shkatërrimi i sigurt duhet të jetë objektivi kryesor i operacioneve për reduktimin apo asgjësimin e armëve, municioneve dhe eksplozivëve të grumbulluar apo që kanë dalë tepër për çfarëdolloj arsyeje’ (UNSG, 2000, neni 13). Ky raport rendit edhe një sërë masash praktike për shkatërrimin e rezervave të tepërta, si dhe disa hapa të ndryshëm parapërgatitës që duhen marrë parasysh përpara shkatërrimit të armëve të vogla dhe të lehta (neni 19). Raporti shpjegon në detaje gamën e gjerë të metodave praktike që mund të përdoren për shkatërrimin e armëve të vogla, armëve të lehta dhe municioneve, duke përfshirë edhe shkrirjen, djegien, shpërthimin, dhe prerjen (UNSG, 2000, pjesa II.B)¹¹. Në vitin 2001, Departamenti i Kombeve të Bashkuara për Çështjet e Çarmatimit (tani Zyra e Kombeve të Bashkuara për Çështjet e Çarmatimit) publikoi një *Manual Shkatërrimi. Armët e vogla, Armët e lehta, Municionet dhe Eksplozivët*, të dizenuar për të ndihmuar ekspertët të zgjedhin metodën e përshtatshme të shkatërrimit (UNDDA, 2001).

Manuali mbi Praktikën më të Mirë për armët e vogla dhe të lehta, i OSBE-së, përfshin një pjesë të titulluar ‘Udhëzuesi i Praktikave më të Mirë mbi Procedurat Kombëtare për Shkatërrimin e Armëve të vogla dhe të lehta’. Udhëzuesi siguron informacion mbi zhvillimin e politikave dhe hartimin e udhëzimeve

dhe procedurave të përgjithshme për shkatërrimin e armëve të vogla dhe të lehta. Mbulon të gjithë procesin, që nga identifikimi i armëve të vogla dhe të lehta të caktuara për t’u shkatërruar deri në asgjësimin përfundimtar të gjithë copave të mbetura (OSBE, 2003b).

Standardet dhe Udhëzimet për Mikro-Çarmatimin Rajonal në Evropën Jug-Lindore (S/UMÇR) u zhvilluan nga Zyra Qendrore e Evropës Jug-Lindore për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të lehta (SEESAC). Ato përcaktojnë parimet udhëzuese në nivelet operacionale dhe të programeve. Këto procedura ndihmojnë qeveritë dhe organizatat ndërkombëtare në Evropën Jug-lindore për të zhvilluar programe shkatërrimi të sigurta, efikase dhe efektive për armët e vogla dhe të lehta (SEESAC, 2006a).

Politikat në praktikë

Asgjësimi nuk nënkupton domosdoshmërisht shkatërrimin apo çmilitarizimin e armëve dhe municioneve (shihni Kutinë 1). Një sërë procedurash të ndryshme janë konsideruar për t’u përdorur për asgjësimin e

rezervave të tepërta, si p.sh. shitja apo dhurimi i tyre shteteve të tjera, muzeve apo koleksionistëve. Disa forca të armatosura mund t’i rigrumbullojnë armët e sekuestruara apo të konfiskuara për t’i përdorur përsëri, si dhe për qëllime trajnimit, ose mund të zgjedhin t’i mbajnë rezervë për një afat kohor të papërcaktuar.

Në vijim paraqitet një përmbledhje e shkurtër e opsioneve të mundshme për asgjësimin e tepërcave.

Shitjet dhe dhurimi. Nëse armët e tepërta janë në sasi të mëdha dhe në gjendje të mirë fizike, mund të kenë potencial të mirë fitimi. Kështu që shitja e rezervave të tepërta mund të jetë një mënyrë jo e kushtueshme asgjësimi (Wilkinson, 2006, fq. 268).

Megjithatë, duhen marrë parasysh një sërë faktorësh përpara se të kryhet transferimi i tepërcave të armëve të vogla dhe të lehta, dhe municioneve të tyre. Nevojiten një sërë kërkesash dhe standardesh të rrepta ligjore për transferimin e përgjegjshëm të armëve dhe për kontrollin e eksportit në mënyrë që të parandalohet trafikimi i paligjshëm i tyre. Gjithashtu, për të shitur apo dhuruar këto armë duhet marrë parasysh kosto e sigurimit, ruajtjes dhe mirëmbajtjes së tyre derisa të gjendet një përfitues final. Në fund, në varësi të kohës së nevojshme për shitjen e tyre, kostot e përmendura më sipër mund të tejkalojnë fitimin e marrë nga shitja¹².

Shkatërrimi. Shkatërrimi është metoda më e besueshme për një eliminim të shpejtë të një volumi të madh armësh dhe municionesh të tepërta¹³. Qëllimi i një programi shkatërrimi efektiv të rezervave është shkatërrimi i arsenaleve në mënyrë të sigurt, efikase, dhe pa kosto të lartë. Nga shkatërrimi i rezervave të tepërta, shtetet mund të sigurojnë fitim financiar nga mbledhja e pjesëve apo ripërdorimi i eksplozivëve. Mbetjet e eksplozivëve në procesin e çmilitarizimit, si p.sh. TNT apo Amatol, mund të shiten për të prodhuar eksplozivë të tjerë.¹⁴ Eksplozivët e rigrumbulluar janë

Kutia 1 Përkufizime

Asgjësimi: heqja e armëve, municioneve dhe eksplozivëve nga rezervat duke përdorur një sërë metodash (të cilat jo domosdoshmërisht përfshijnë shkatërrimin). Në mbarë botën përdoren gjashtë metoda tradicionale asgjësimi nga forcat e armatosura: shitja, dhurimi, shkatërrimi, trajnimi dhe përdorimi, grumbullimi dhe magazinimi.

Çmilitarizimi: e gjithë gama e proceseve që i bëjnë armët, municionet, minat dhe eksplozivët të papërshtatshme për të përbushur qëllimin për të cilat ishin krijuar (IMAS, 2003). Çmilitarizimi përfshin jo vetëm procesin përfundimtar, që është shkatërrimi, por edhe transportin, futjen nëpër depo, llogaritjen, dhe operacionet parapërpunuese të cilat janë po aq të rëndësishme për përbushjen e rezultatit përfundimtar.

Shkatërrimi: procesi i transformimit përfundimtar të armëve, municioneve, minave dhe eksplozivëve në gjendje inerte, që të mos kryejnë më funksionin për të cilin ishin krijuar.

(Burimi: Bevan and Wilkinson, 2008, fq. Xxi-xxii).

vetëm për përdorim tregtar apo civil.

Përdorim vetjak (për trajnim apo për t'iu shpërndarë ministrive).

Disa shtete ua japin armët e tepërta nga arsenali shtetëror dhe armët e konfiskuara agjencive të sigurimit dhe njësisë ushtarake. Nëse armët e sekuestruara, konfiskuara apo grumbulluara i përmbushin standardet kombëtare të pajisjeve të policisë, ato mund t'i jepen policisë sipas nevojave të saj operacionale. Armët dhe municionet e tepërta mund të përdoren edhe për trajnime nga forcat e armatosura. Megjithatë, specialistët dhe ekspertët

argumentojnë se edhe ky opsion ka disa të meta¹⁵. Rritja e nivelit të trajnimit dhe qitjes vetëm për të harxhuar tepërcën kërkon kohë dhe mund të mos jetë metoda më efikase, në varësi të sasisë së municioneve që duhen eliminuar¹⁶.

Ruajtja në depo. Në shumë raste, autoritetet i mbajnë armët dhe municionet e tepërta nëpër depo për një periudhë kohe pa afat. Justifikimet e përdorura janë mungesa e burimeve financiare, kapacitetit teknik, dhe infrastrukturës së duhur për shkatërrimin e tyre, ose thjesht që asnjë

blerës nuk ka shprehur dëshirën për t'i blerë. Për magazinimin e armëve dhe municioneve të tepërta nëpër depo duhet investuar për gjetjen e ambienteve të ruajtura mirë dhe për përdorim të procedurave me nivel të lartë sigurie. Megjithatë, kostoja e magazinimit të tyre reduktohet nëse zbatohet procedura e identifikimit dhe shkatërrimit të shpejtë të tepërcave.

Koleksionet, muzetë, dhe ekspozitat. Artikuj individualë nga rezervat e tepërta mund të ruhen në muze apo të ekspozohen në ekspozita të ndryshme; mund të shiten apo t'i dhurohen koleksionistëve. Nëse shtetet mbajnë rezerva të tepërta për këto arsye, duhet të sigurojnë që këto armë/municione të çaktivizohen përgjithmonë dhe të nxirren jashtë përdorimit. Disa vende të Evropës Jug-lindore përdorin këtë qasje për një numër të vogël armësh. Kështu, Mali i Zi po përgatit një ekspozitë në një nga ndërtesat kryesore të policisë në Podgoricë ku do të ekspozohen armë historike e të tjera¹⁷.

Trajtimi i rezervave të tepërta shtetërore

Shumë prej vendeve të Evropës Juglindore janë në proces ristrukturimi të forcave të tyre të armatosura dhe të sigurisë¹⁸. Ky proces përfshin ndryshime të kërkesave të armëve dhe si rezultat rritet numri i rezervave të tepërta që duhen eliminuar. Në një deklaratë të përbashkët, ministrinë e mbrojtjes të shteteve pjesëmarrëse në Procesin e Bashkëpunimit të Evropës Juglindore¹⁹ në Sofje në vitin 2008, pranuan ekzistencën e tepërcave të mëdha në armë dhe municione. Në deklaratë, ministrat pranuan se 'ekzistenca e armatimeve, municioneve dhe pajisjeve ushtarake të tepërta vazhdon të përbëjë problem në Evropën juglindore' dhe shprehën gatishmërinë e tyre për të bashkëpunuar dhe ndarë eksperiencën në lidhje me përdorimin e këtyre tepërcave. Gjithashtu, ata ranë dakord 'të kërkojnë të bashkëpunojnë me organizatat ndërkombëtare dhe vendet donatore'



Shkatërrimi i artilerisë së pashpërthyer © NAMSA

Tabela 1 **Metodat e asgjësimit të rezervave të tepërta**

	Shitjet	Donacionet		Shkatërrimi	Përdorim vetjak		Shndërrimi në armë gjahu apo mbrojtjeje
		Vendeve të tjera	Muzeve		Për trajnim	Shpërndarje nëpër ministri	
Shqipëria	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>		<input type="radio"/>	<input type="radio"/>		
Bosnja dhe Hercegovina	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>			
Bullgaria	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>		<input type="radio"/>			
Kroacia	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>		<input type="radio"/>			
Maqedonia	<input type="radio"/>			<input type="radio"/>		<input type="radio"/>	
Mali i Zi	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>		<input type="radio"/>	<input type="radio"/>		
Rumania	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>		<input type="radio"/>		<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Serbia	<input type="radio"/>			<input type="radio"/>			
Slovenia		<input type="radio"/>		<input type="radio"/>			

(SEECIP, 2008). Por, deklarata nuk përfshin ndonjë dispozitë për shkatërrimin e tepërcave, vetëm për përdorimin e tyre.

Qeveritë e Evropës Juglindore janë më tepër pro shitjes së armëve dhe municioneve të tepërta sesa shkatërrimit të tyre. Tabela 1 ilustron mënyrat e ndryshme të asgjësimit të armëve të tepërta nga arsenalit i forcave të armatosura dhe policisë. Sipas studimeve, vendet e rajonit tentojnë t'i shesin tepërcat, me kusht që të jenë funksionale, në gjendje të mirë fizike dhe të sigurta për t'u transportuar²⁰. Studimet tregojnë se shumica e vendeve të rajonit shohin mundësinë e dhurimit të këtyre tepërcave vendeve të tjera, ndërsa pak prej tyre përpunohen t'i shpërndajnë nëpër ministritë dhe entet shtetërore (Maqedonia dhe Rumania). Raportet dhe manualët kombëtarë tregojnë se ka tepërcat që shkatërrohen. Por kjo ndodh vetëm në rastet kur nuk mund të shiten. Stimujt financiarë dhe perspektiva e asgjësimit të shpejtë të rezervave të tepërta i nxisin shtetet t'i nxjerrin këto tepërcat në shitje nëpërmjet tenderimit dhe jo t'i shkatërrojnë. Edhe kur shkatërrimet masive të armëve dhe municioneve të tepërta financohen nga donatorë ndërkombëtarë²¹, përfitimet financiare që mund të ketë një shtet janë tërheqëse (Griffiths, 2008, fq. 187).

Parimi që përdorin shumë vende të rajonit është: së pari përpjekje për të shitur, pastaj dhurimi, dhe në fund fare shkatërrimi. Kjo është më se e vërtetë për armët e vogla dhe të lehta. Nga ana tjetër, nuk është gjithmonë e lehtë të shesësh municionet e tepërta, sepse mund të jenë të paqëndrueshme dhe të përbëjnë rrezik²². Të gjitha vendet e rajonit përballen me nevojën për të shkatërruar municionet e tepërta dhe lloje të tjera tepërcash.

Në vazhdim paraqitet një përmblendje e të gjithë direktivave kombëtare të mundshme të Evropës Juglindore apo të procedurave qeveritare në lidhje me asgjësimin e tepërcave²³. Fokusi qëndron mbi metodat e asgjësimit të përdorura për armët e tepërta (shtetërore) nga arsenalit i forcave të armatosura dhe policore.

Bosnja dhe Hercegovina

Sipas Marrëveshjes për Heqjen Përfundimtare të të Gjithë të Drejtave dhe Detyrimeve mbi Pasurinë e Patundshme që shërben për qëllime mbrojtjeje, presidenca e Bosnje-Hercegovinës miraton asgjësimin e tepërcave me sugjerim të Ministrisë së Mbrojtjes. Ministria nxjerr vendim, ku deklarohen tepërcën e vet, duke përfshirë edhe një rekomandim për asgjësimin. Metodat

e asgjësimit janë shitja, dhurimi, dhe shkatërrimi (Bosnja dhe Hercegovina, 2008, neni 6.1).²⁴ Pas miratimit të qeverisë, Ministria e Mbrojtjes ngre një komision për zbatimin e procedurës së miratuar të asgjësimit (neni 6.2). Të ardhurat nga shitja apo shkatërrimi transferohen në Thesarin Kombëtar dhe përdoren për të rimbursuar kostot e shitjes apo të shkatërrimit të tepërcave (neni 7.a). 20% e të ardhurave të tjera transferohen në një llogari të veçantë të Ministrisë së Mbrojtjes, brenda llogarisë së Thesarit, dhe pjesa tjetër prej 80% shpërndahet në mënyrë proporcionale midis dy njësisve që siguruan tepërcat (neni 7.b, 7.c).

Bosnja dhe Hercegovina ka prioritet shkatërrimin e municioneve të tepërta, të paqëndrueshme dhe në kushte kritike. Gjithashtu, bëhet shkatërrimi i armëve dhe municioneve të dorëzuara dhe të sekuestruara (shihni më poshtë) (Bosnja dhe Hercegovina, 2010, fq.9). Donacionet e mëparshme që i janë dhënë Forcave të Armatosura të Bosnjes, dhe që janë identifikuar si tepërcë, nuk shiten apo dhurohen, por shkatërrohen.²⁵ Për pjesën e mbetur të tepërcës, Ministria e Mbrojtjes duhet të bëjë të paktën dy përpjekje për të shitur armët dhe municionet e tepërta nëpërmjet tenderimit. Nëse tepërcat nuk

mund të shitet, atëherë shkatërrohet.²⁶ Organizatat ndërkombëtare dhe shtetet donatore luajnë rol kryesor në asgjësimin e tepricës dhe administrimin e rezervave të Bosnjes. Projektet e PNUD-it janë gjithmonë e më të suksesshme. Sipas këtij artikulli, Shtetet e Bashkuara po fillojnë një program shumëdimensional me fokus çmilitarizimin e municioneve dhe armëve nga Ministria e Mbrojtjes dhe BE-ja do të mbikëqyrë trajnimin e personelit ushtarak për administrimin e rezervave. Bosnja dhe Hercegovina ka dhuruar pjesë të tepricës enteve të vendeve të tjera. Një dhurim iu bë Ushtrisë Kombëtare të Republikës Islamike të Afganistanit në vitin 2009 (SEESAC, 2009)²⁷; një tjetër — 23 armë të vogla — iu dhuruan Ministrisë së Mbrojtjes së Austrisë për Muzeun e Historisë Ushtarake në Vjenë (Kauer, 2007, p. 91).²⁸ Këto armë ruhen në magazina në kushte jo të mira dhe përbëjnë rrezik për mjedisin dhe popullsinë përreth, kështu që u dhanë si donacion.

Bullgaria

Në këtë shkrim, më shumë se 20,000 tonë municione, përfshirë municionin për armët e vogla, identifikohen si teprica municioni nga Ministria e Mbrojtjes (MM) së Bullgarisë. Ristrukturimi dhe modernizimi i mëtejshëm i Forcave të Armatosura Bullgare mund të rrisë tepricën me 30,000 tonë të tjera municione.²⁹ Sipas raportit kombëtar të Bullgarisë për vitin 2010 lidhur me zbatimin e Programit të Veprimit, rezervat e tepërta ose shiten ose shkatërrohen (Bullgari, 2010, fq. 17). Që prej vitit 2005 janë shkatërruar më shumë se katër tonë me ndihmën e financimeve të jashtme nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PNUD-i) dhe Departamenti Amerikan i Shtetit (Nikolov, 2010).

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm është kryesisht përgjegjës për përkufizimin e rezervave të tepërta dhe për miratimin dhe përditësimin e Listës vjetore të Materialeve Rezervë. Një komision i përbërë nga anëtarë të MM-së, forcat e armatosura, dhe komitete të tjera qeveritare, vendos të ruajë, shesë, përdorë ose shkatërrojë rezervat. Mesa duket, procedura e parapëlqyer për asgjësimin e tepricave në Bullgari është 'së pari ta shesë, pastaj ta dhurojë dhe më në fund ta asgjësojë atë' (Faltas, 2008, fq. 86-88). Bullgaria raporton se ajo siguron aplikimin e kontrolleve rigorozë të eksportit të shitjeve të rezervave, duke kontrolluar përdoruesin e fundit dhe vendin e destinacionit para se të autorizojë transferimin duke siguruar përmbushjen e të gjitha angazhimeve të saj ndërkombëtare lidhur me këtë. Sapo një shitje ka përfunduar, qeveria kontrollon kontraktuesin.³⁰ Rezervat që nuk ka qenë e mundur të shiten apo të shkatërrohen, priten në copa dhe hapen nën mbikëqyrjen e një komisioni të specializuar (Bullgaria, 2010, f. 17).

Kroacia

Në Strategjinë Kombëtare dhe Plan e saj të Veprimit për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta, Kroacia shprehet se armët e tepërta shkatërrohen, shiten ose dhurohen. Veç kësaj, plani shprehet se shkatërrimi i raketave tokë-ajër ka përparësi (Kroacia, 2009, fq. 12, 18). Plani Afatgjatë i Zhvillimit 2006 – 2015 për Forcat e Armatosura Kroate veçon disa armë të lehta si të tepërta, që i korrespondojnë zvogëlimit të forcave të armatosura. Dokumenti identifikon 372 raketa tokë-ajër, 953 mortaja dhe 58 predha anti-tank si teprica pasi ato e tejkalojnë sasinë e armëve që nevojitet

për elementin aktiv dhe atë rezervë të forcave të armatosura. Dokumenti nuk përmend teprica të armëve të vogla apo municionin e tyre, dhe as nuk specifikon sesi duhen shkatërruar këto teprica (Kroacia, 2006, fq. 22).

Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura Kroate përcakton tepricat bazuar në një analizë të vazhdueshme të rezervave të nevojshme.³¹ Nëse armët janë teprica dhe duhen shitur ose asgjësuar vendoset nga MM-ja pas rekomandimeve të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Vendimi i MM-së bazohet në Rregulloren për Shitjen e Armëve dhe Pajisjeve të Mbrojtjes të dala jashtë përdorimi, neni i parë i së cilës thotë se tepricat përcaktohen sipas kushtit teknik të armëve dhe municionit, dhe në përputhje me planet e zhvillimit të strukturës së forcës për forcat e armatosura. Neni 4 shprehet se lista e mallrave të dala jashtë përdorimi duhet përditësuar katër herë në vit. Komisioni i prokurimit raporton lidhur me tepricat e dala jashtë përdorimit dhe rekomandon veprimet vijuese, të cilat mund të jenë në formë shitjesh ose heqjesh nga inventari (Kroaci 2002, Nenet 4-5)³². Zëvendësministri i pajisjeve dhe rezervave inkurajon më pas Ministrin e Mbrojtjes që të marrë një vendim për shitjen e armëve të dala jashtë përdorimit dhe përcakton çmimin fillestar të shitjes. Nëse stoqet e paracaktuara për shitje në tregun ndërkombëtar nuk mund të shiten me procedurë tenderimi, atëherë mund të ofrohet një çmim më i ulët për shitje, ose mund të bëhet dhurimi i mallrave. Në këtë pikë, tepricat mund edhe të hiqen nga inventari, të ruhen ose të shkatërrohen sipas procedurave të përcaktuara, duke përdorur ambientet e forcave të armatosura (Kroacia, 2002, neni 13; 2010, fq. 13)³³.

Mali i Zi

Në Planin Strategjik për Kontrollin dhe Reduktimin e Armëve të Vogla dhe të Lehta të vitit 2005, Mali i Zi njihet nevojën për të pakësuar tepricat

Tepricat e identifikuar për t'u nxjerrë në shitje iu ofrohen kompanive përmes një procedure tenderimi

e armëve të vogla dhe municionet e tyre. Një prej synimeve operative të dokumentit strategjik ishte shkatërrimi i të gjitha tepricave të armëve të vogla dhe armëve të lehta (Mali i Zi, 2005, fq. 9). Pas pesë vjetësh, sasi të konsiderueshme tepricash armësh (MB) dhe municionesh (MD dhe MB/policia)³⁴ janë ende në pritje për t'u asgjësuar. Qeveria pranon në Dokumentin strategjik për Forcat e Mbrojtjes se nuk ka mjete të mjaftueshme financiare për të shkatërruar tepricat e saj (Mali i Zi, 2010, fq. 57); për pasojë, ajo është e varur nga mbështetja e donatorëve ndërkombëtarë.³⁵

Ministri i Mbrojtjes ngre një komision që përfshin disa përfaqësues të MB-së, Shtabit të Përgjithshëm, dhe teknike për të identifikuar kushtet teknike të rezervave ushtarake. Sipas nevojave të forcave të armatosura dhe vlerësimit teknik të inventarit, ky komision merr një vendim lidhur me elementet që duhen identifikuar si teprica. Ai këshillon qeverinë se cilat pjesë mund të shiten dhe cilat duhen asgjësuar. Në vijim të këtij propozimi, Qeveria e Malit të Zi merr vendim lidhur me asgjësimin përfundimtar të tepricave. Rezervat e tepërta nga forcat e armatosura të Malit të Zi dhe të policisë shiten në tregun ndërkombëtar, dhurohen ose asgjësohen. Përparësi për asgjësim kanë tepricat e armëve dhe municioneve që përbëjnë kërcënim për shkak të gjendjes së tyre jo të mirë ose që nuk mund të shiten.³⁶ Legjislativioni i Malit të Zi për Pronën Shtetërore i jep përparësi menaxhimit ekonomik, shfrytëzimit dhe përdorimit të të gjithë pronës shtetërore, përfshirë armët dhe municionet (Mali i Zi, 2009, nenet 21, 22). Tepricat që identifikohen për shitje iu ofrohen përmes një procedure tenderimi kompanive që kanë licencë për të tregtuar armë dhe municion. Në vitin 2007, MM-ja identifikoi disa tonë teprica municionesh, armësh të vogla, dhe armësh të lehta për asgjësim sipas një projekti për Çmilitarizim të Malit të Zi (MONDEM) të financuar nga OSBE-ja dhe nga

PNUD-i (OSBE-ja dhe PNUD-i, 2007). Sidoqoftë, qeveria mbajti mënjandis disa armë dhe municione, të cilat u përpoq t'i shiste përmes një procedure tenderimi. Meqë nuk u identifikua asnjë blerës pas tre apo, siç ndodhi në disa raste, katër procedurash tenderimi, këto armë iu shtuan në mënyrë retroaktive listës së armëve dhe municioneve që do të asgjësoheshin gjatë projektit MONDEM.³⁷ Sidoqoftë, së fundmi disa kompani treguan interes për të blerë disa prej armëve dhe municioneve të përzgjedhura për asgjësim gjatë programit MONDEM. Meqë PNUD-i dhe OSBE-ja nuk i kanë burimet financiare për t'i asgjësuar krejtësisht të gjitha tepricat e identifikuar për asgjësim, Qeveria e Malit të Zi, do të kërkojë leje nga PNUD-i që të tërheqë disa prej artikujve që pritet të asgjësohen dhe t'i shesë ato.³⁸ Luhatjet në situatën financiare dhe kërkesa në rritje për armë dhe municion mund të shpjegojë këtë interes të papritur për blerjen e tepricave të Malit të Zi.

Në identifikimin e tepricave të armëve të mbajtura nga policia, këshilli i drejtorisë së policisë merr në konsideratë sugjerimet e një komisioni të përbërë nga drejtorja e policisë, armëpunuesit nga depot e policisë, dhe ekspertë të tjerë.³⁹

Proceset ristrukturuese të policisë prej vitit 2005 rezultuan në teprica të konsiderueshme armësh dhe municionesh. Disa prej depove të municioneve të kontrolluara nga policia ndodhen në zonat urbane në Podgoricë, duke përbërë kërcënim të konsiderueshëm për popullatën lokale dhe ambientin, pasi ambientet e magazinimit nuk janë të përshtatshme.⁴⁰ Për të shmangur rrezikun e shpërthimeve dhe diversionin, policia vendosi të asgjësojë shumicën e tepricave dhe të boshatiste depot urbane. Deri më sot, të gjithë 54 raketat tokë-ajër, që mbaheshin nga policia, janë asgjësuar nëpërmjet shpërthimeve në ambiente të hapura;⁴¹ sidoqoftë, nuk është përjashtuar mundësia e shitjes apo

dhurimit të një pjese tjetër të tepricave.⁴² Për përcaktimin dhe konfirmimin e asgjësimit përfundimtar të kësaj teprice do të ngrihet një komision, i cili ka shumë gjasa që të përbëhet nga përfaqësues të një institucioni gjyqësor, drejtorja e policisë, MB-ja dhe shoqëria civile.⁴³

Maqedonia

Sipas raportit kombëtar të Maqedonisë për vitin 2010 lidhur me zbatimin e Programit të Veprimit, armët e tepërta ose shiten ose shkatërrohen (Maqedonia, 2010, fq. 12). Praktika shtetërore sugjeron që tepricat nga MM-ja dhe Ministria e Brendshme që mund të përdoren akoma dhe që nuk janë planifikuar të shkatërrohen, të shiten, apo t'i jepen ministrive të tjera apo organeve kombëtare që lejohen të mbajnë armë. Shembuj janë Ministria e Drejtësisë për përdorim nga ana e policisë gjyqësore, ose Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave që të përdoren nga Policia e Pyjeve. Maqedonia lejon transferimin e tepricave të armëve nga njëra ministri tek tjetra.⁴⁴

Deri më sot, Maqedonia as nuk i ka shitur dhe as nuk i ka ofruar ndërkombëtarisht tepricat e armëve përmes një procedure tenderimi. Të gjitha armët e tepërta u janë shpërndarë ministrive për përdorim, ose janë shkatërruar; po ashtu janë asgjësuar edhe armët e vogla që nuk përdoren.⁴⁵ Maqedonia nuk ia dhuron tepricat e saj ndonjë vendi tjetër.

Rumania

MM, MB dhe institucione të tjera publike të Rumanisë që kanë personel të armatosur i identifikojnë çdo vit rezervat e tepërta. Komanda e Përbashkët Logjistike e MM-së dhe Ministrisë së Administratës dhe Drejtorisë së Përgjithshme Logjistike të MB-së japin rekomandimet e tyre për asgjësimin e rezervave të tepërta.⁴⁶ Ndaj, Këshilli i Mbrojtjes Kombëtare i miraton rekomandimet në fillim të çdo viti (Faltas, 2008, fq. 94-95).

Në raportin e saj kombëtar të vitit 2003 mbi zbatimin e Programit të Veprimit, Rumania shprehet se tepricat nga MM-ja ose shpërndahen pa pagesë nëpër institucionet e tjera publike⁴⁷ sipas radhës ose asgjësohen (Rumani, 2003, fq. 10). Udhëzuesit e Rumanisë që rregullojnë shitjen e mallrave të administruara nga Ministria e Mbrojtjes lënë të kuptohet se tepricat edhe shiten (Rumania, 2005). Një urdhëresë urgjente e MM-së, ndryshuar në vitin 2001, tregon se asgjësimi i tepricave duhet të jetë sa më fitimprurës që të jetë e mundur (Faltas, 2008, fq. 97), që do të thotë se rezervat e tepërta duhet të shiten. Vendimi i qeverisë për miratimin e udhëzuesit lidhur me shitjen e mallrave të administruara nga MM-ja autorizon kompaninë Romtehnica, e cila është në pronësi të shtetit, që të shesë tepricat e pajisjeve ushtarake, të cilat mbaheshin më parë nga MM-ja (Rumani, 2005, neni 2). Mallrat duhen eksportuar brenda gjashtë muajve, me të drejtën për të kërkuar një shtyrje prej gjashtë muajsh të tjerë (Faltas, 2008, fq. 96; Rumania, 2005, neni 33.2). Nëse nuk mund të bëhet një shitje jashtë vendit, kompanisë i lejohet që t'i shesë artikujt në tregun lokal, për sa kohë që armët janë nxjerrë nga lista e dokumentuar dhe janë çmilitarizuar (Rumania, 2005, neni 3.4). Çmimi fillestar i shitjes për të cilin është rënë dakord përmes një procedure tenderimi nuk duhet të jetë më i ulët sesa vlera e mbetjeve që do të rezultonte nga asgjësimi i mallrave (neni 10.4). Mbetjet që mbeten nga eliminimi i municioneve gjithashtu shitet nëpërmjet Romtehnica (neni 33.3).

Të ardhurat nga shitjet e tepricave i përkasin MM-së. Ato do të përdoren për të blerë pajisje për modernizimin e ushtrisë (Faltas, 2008, fq. 98). Fitimet nga shitjet e mbetjeve që mbeten pas eliminimit të municionit përdoren për të paguar për eliminime të municioneve të tjera (Rumania, 2005, neni 33.4). Rumania ka të drejtë të dhurojë tepricat e armëve dhe të municioneve, ose t'i shndërrojë ato në armë gjuetie ose në

armë për mbrojtje personale (Faltas, 2008, fq. 97).

Ministria e Çështjeve Ekonomike dhe Tregtisë dhe kompania e lidhur më të, Romarm, asgjësojnë tepricat nga MB-ja. Romarm ose i shet tepricat, ose i çmilitarizon ato brenda ambienteve të MM-së (Faltas, 2008, fq. 98).

Serbia

Në Strategjinë e saj për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta, Serbia prezanton plane për të krijuar kushtet materiale dhe financiare për asgjësimin e sigurt të rezervave të tepërta (Serbia, 2010, fq. 6). Metoda e heqjes është ose shitje ose asgjësim. Në rast se identifikohet një tepricë, ajo iu ofrohet për shitje kompanive kombëtare, të cilat kanë licencë për të tregtuar mallra ushtarake, përmes një procedure tenderimi. Nëse nuk ka asnjë blerës, tepricat ka gjasa që të asgjësohen sipas standardeve ndërkombëtare të asgjësimit.⁴⁸ Evidenca tregon se një pjesë e materialeve të tepërta serbe shiten jashtë vendit.⁴⁹ Sipas politikës dhe praktikës së saj, Serbia është një nga vendet e pakta në rajon që nuk i dhuron tepricat e saj.

Divizioni logjistik i Shtabit të Përgjithshëm të Serbisë është përgjegjës për klasifikimin e tepricave së bashku me departamentin për burimet materiale. Armët kontrollohen për rezistencën e tyre, kushtet teknike dhe përdorimin. Sipas këtyre aspekteve, Shtabi i Përgjithshëm identifikon atë që është tepricë dhe bën një sugjerim lidhur me asgjësimin e saj. Me pas MM-ja merr një vendim për mënyrën e asgjësimit të tepricës.⁵⁰ Studimet tregojnë se deri tani, asgjë në inventarin e MM-së nuk është deklaruar si tepricë, përveç disa njësisive raketash tokë-ajër të asgjësuar me financim nga SHBA si pjesë e një prej programeve më të mëdha për asgjësimin e raketave tokë-ajër (Serbia dhe Mali i Zi, 2004, fq. 5; Griffiths, 2008). Ato që identifikohen si teprica janë armë të sekuestruara, konfiskuara, ose të gjetura (shih më poshtë).

Shqipëria

Forcat e Armatosura Shqiptare (FASH) administrojnë dhe ruajnë një sasi të konsiderueshme municioneve të tepërta. Rreth 90% janë mbi 40 vjeçare. Si rezultat, një pjesë e madhe po humbet tashmë aftësitë fizike dhe kimike. Degradimi i tepërt mund të rrisë mundësinë e shpërthimeve të paplanifikuara si shkak i një shpërthimi auto-katalizues. Sipas këtij materiali, ndodhen rreth 75,000 ton municione të depozituara në depo të veçanta; 25% e ushtarëve të FASH-it janë të përfshirë në sigurimin e këtyre vendndodhjeve⁵¹.

Në Planin e Veprimit për Asgjësimin e Municioneve të Tepërta të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë 2009-2015, Shqipëria angazhohet që deri në vitin 2015 të identifikojë dhe eliminojë të gjithë sasinë e municioneve dhe eksplozivëve të vjetër, të tepërt, që ndodhen në inventarin e FASH-it (Shqipëria, p.d.a, fq. 4). Plani i Veprimit identifikon pesë metoda asgjësimi: a) asgjësimi industrial; b) djegia; c) shpërthim i hapur në pikat e çmontimit; d) qitja; e) shitja ose dhurimi (fq.8).

Ministria e Mbrojtjes e Shqipërisë ka autorizimin për të vendosur dhe miratuar tepricat sipas rastit⁵². Kjo ministri ka të drejtën të vendosë t'i shkatërrojë ose t'i shesë këto teprica. Vendimi merret në bazë të riskut që përbëjnë tepricat si pasojë e gjendjes fizike dhe afërsisë me zonat e banuara (Shqipëria, p.d.a, fq. 15-18).

Vendimi i Këshillit të Ministrave të Shqipërisë Nr. 365, datë 6 qershor 1994, për asgjësimin ose shitjen e municioneve, të cilave u ka kaluar afati i jetëgjatësisë, për shitjen e tepricës dhe stoqeve të armatimeve dhe municioneve, si dhe për shitjen e armëve të zjarrit dhe municioneve të tepërta apo rezervë, autorizon Ministrinë e Mbrojtjes të 'shkatërrojë ose shesë ato municione këmbësorie, xhenio, artilerie, etj, të cilave u ka kaluar afati i jetëgjatësisë, ose janë afër tij'. Kjo ministri është e autorizuar 'të shesë armët e zjarrit dhe municionet e tepërta apo stoqe'. Sipas vendimit,



Mbetje municionesh të armëve të vogla API të kalibrët 14.5mm, pas djegies së kontrolluar të tyre në Shqipëri © NAMSA

shitja duhet të kryhet sipas çmimit më të mirë të mundshëm të tregut (SEESAC, 2004, fq. 61).⁵³ Nëse tepricat shkatërrohen, mbetjet eksplozive që mbeten pas procesit të çmilitarizimit – si p.sh. TNT apo Amatol – u shiten fabrikave vendase apo ndërkombëtare të prodhimit të eksplozivëve për përdorim civil (Shqipëria, p.d.b, fq. 3).⁵⁴

FASH vazhdon angazhimin e vet për asgjësimin e tepricave me mbështetjen e donatorëve kryesorë ndërkombëtarë. Aktivitetet e NATO-s në vitet 2004-2007 dolën të suksesshme dhe SHBA-të janë aktualisht donatori që financon shkatërrimin e armëve dhe municioneve të tepërta, rregullimin e vendit të shpërthimit në Gërdec, dhe trajnimin e FASH-it për sigurinë fizike dhe administrimin e rezervave.

Slovenia

Sipas raportit kombëtar të Sllovenisë për vitin 2008, lidhur me zbatimin e

Programit të Veprimit, asgjësohen të gjitha armët e ndaluara, të papërdorura, të rrezikshme dhe të tjetërsuara (Sllovenia, 2008, fq. 10). Armët e përdorura nga policia nuk shiten. Nëse armët janë zhvlerësuar apo kanë dalë jashtë përdorimit, atëherë ato asgjësohen. Për asgjësimin e duhur të këtyre armëve, MB-ja së pari klasifikon armët e sekuestruara, të gjetura, të konfiskuara dhe të dorëzuara. Armët ushtarake, të cilat përdoren nga policia dhe pastaj hiqen nga përdorimi, i dorëzohen MM-së.⁵⁵

Lidhur me asgjësimin e tepricave të MM-së ka shumë pak njohuri. Sllovenia i ka dhuruar armë dhe municione Forcave Afgane për Sigurinë Kombëtare (NATO, 2010). Ky material ishte tepricë.⁵⁶ Sidoqoftë, MM-ja e Sllovenisë nuk dha ndonjë informacion shtesë për këtë studim sa i takon procedurës dhe metodave të parapëlqyera për asgjësimin e rezervave të tepërta shtetërore.

Trajtimi i armëve të sekuestruara dhe të konfiskuara

Sa i takon armëve të mbajtura nga civilët, përcaktimi nëse armët janë teprica apo jo shpeshherë bëhet me vendim nga një gjyqtar. Në vijim të një hetimi penal, gjyqtari përcakton nëse arma mund t'i kthehet pronarit apo duhet të mbahet e konfiskuar, duke u bërë kështu pronë e shtetit. Metodot e asgjësimit të përdorura nga vendet e Evropës Juglindore për tepricat (civile) të mbledhura përmes sekuestrimit dhe konfiskimit janë të llojeve të ndryshme. Tabela 2 ilustron faktin që të gjitha vendet në rajon i asgjësojnë disa nga armët e sekuestruara dhe të konfiskuara.⁵⁷ Ashtu siç do ta ilustrojmë më vonë në këtë pjesë, ekzistojnë prova që armët e sekuestruara dhe të konfiskuara përgjithësisht caktohen për asgjësim kur janë të ndaluara, të papërdorshme,

Tabela 2 **Metodat e asgjësimit të armëve të sekuestruara dhe të konfiskuara**

	Shitjet	Donacionet		Shkatërrimi	Përdorim vetjak		Shndërrimi në armë gjahu apo mbrojtjeje
		Vendeve të tjera	Muzeve		Për trajnim	Shpërndarje nëpër ministri	
Bosnja dhe Hercegovina				○			
Bullgaria	○			○		○	
Kroacia	○			○		○	
Maqedonia	○		○	○		○	
Mali i Zi			○	○		○	
Rumania	○			○			
Serbia				○			
Slovenia	○	○ ⁵⁸	○	○		○	

jashtë përdorimit, ose të rrezikshme. Përveç Bosnje-Hercegovinës, Malit të Zi dhe Serbisë, të gjitha vendet në rajon parashohin gjithashtu mundësinë e shitjes së të gjitha armëve të sekuestruara dhe të konfiskuara që nuk janë të ndaluara. Disa vende i shpërndajnë armët nëpër ministrinë e tyre. Paragrafët e mëposhtëm shpjegojnë se si vendet e Evropës Juglindore i asgjësojnë armët e sekuestruara dhe të konfiskuara nga civilët.

Bosnja dhe Hercegovina

Bosnja dhe Hercegovina i asgjëson të gjitha armët e sekuestruara, të konfiskuara, të mbledhura dhe të dorëzuara. Ato nuk i jepen për përdorim asnjë orgai kombëtar,⁵⁹ por i dorëzohen stacioneve të policisë lokale, ku ruhen deri në kohën e asgjësimit (Bosnja dhe Hercegovina, 2010, fq. 9). Ligji për Armët dhe Municionet e Republikës Srpska, për shembull, parashikon që një pronar, të cilit i është anuluar leja e regjistrimit të armës, të mund ta shesë armën apo armët e tij. Nëse një armë nuk shitet, arma e sekuestruar bëhet pronë e Republikës Srpska. Po ashtu, nëse pronari i një arme të gjetur nuk identifikohet brenda një viti, arma bëhet pronë e Republikës dhe asgjësohet (SEESAC, 2004, fq. 196).

Bullgaria

Raporti kombëtar i Bullgarisë për zbatimin e Programit të Veprimit vëren që armët e vogla dhe të lehta të sekuestruara dhe të braktisura, të mbajtura nga MB-ja bëhen pronë e shtetit. Ato përdoren nga organet shtetërore, shiten, ose asgjësohen, në varësi të gjendjes së tyre (Bullgaria, 2010, fq. 17).

Kroacia

Ligji i Kroacisë për Armët parashikon që në rast se autoritetet sekuestrojnë armë zjarri (për shembull, si pasojë e anulimit të lejes së një arme zjarri) pronari ka dy muaj kohë për të shitur ose dorëzuar armën e zjarrit; përndryshe autoriteti kompetent konfiskon armën dhe ia jep atë një tregtari të autorizuar për ta shitur. Nëse tregtari nuk mund ta shesë armën brenda tre muajsh, ajo i dorëzohet MB-së dhe është një komision i caktuar nga MB-ja që vendos lidhur me mënyrën e asgjësimit, e cila mund të përfshijë: futjen e armës në fondin e armatimeve të policisë; dorëzimin e saj në MM; Ministrinë e Drejtësisë dhe Administratës, apo në ndonjë autoritet apo institucion tjetër qeveritar; shitjen e saj përmes një tregtari tjetër të autorizuar; ose asgjësimin e saj (SEESAC, 2004, fq. 273 – 74).

MB e Kroacisë asgjëson rregullisht armët e mbledhura dhe të dorëzuara. Armët e zjarrit të mbledhura dhe të dorëzuara, të cilat nuk i bëjnë punë policisë, shkrihen. Sapo bëhet një sasi e mjaftueshme, MB-ja mbledh armët e vogla nga të gjitha depot rajonale të policisë dhe i çon ato tek metalurgjia në Sisak; municionet dhe pajisjet shpërthyesë çohen në territoret e MM-së ku bëhet shkatërrimi i tyre përmes shpërthimit të hapur.⁶⁰

Mali i Zi

Armët e sekuestruara dhe të konfiskuara në Mal të Zi mbahen në dy ish-burgje në Podgoricë.⁶¹ Ato qëndrojnë atje derisa të përfundojnë hetimet penale lidhur me to, në varësi të të cilave ato ose u kthehen pronarëve të tyre ose asgjësohen. Neni 63 i Ligjit të Malit të Zi për Armët parashikon që armët që sekuestrohen gjatë procedimeve penale apo që gjenden dhe nuk raportohen si të humbura brenda një viti që nga koha e gjetjes së tyre, mund të përdoren për operacionet e elementëve të brendshëm, mund t'i jepen muzeut ose mund të shkatërrohen' (SEESAC, 2004, fq. 911-12).

Sipas praktikës shtetërore, armët e sekuestruara dhe të konfiskuara nuk përdoren nga policia apo ndonjë ent tjetër qeveritar, dhe nuk ofrohen për



Rezervat e armëve dhe municioneve nga forcat policore Malazeze, të ruajtura në Podgoricë, Mal të Zi.
© Jasna Lazarevic/Sondazhi për Armët e Vogla

shitje.⁶² Po kështu, shkatërrohen edhe armët e dorëzuara.⁶³ Një vendim gjyqësor i nxjerrë së fundmi identifikoi 115 armë të konfiskuara apo të sekuestruara, të cilat duhet të shkatërrohen. Meqë policia nuk i ka burimet financiare për t'i asgjësuar ato, ato do të shkatërrohen sipas një marrëveshjeje teknike midis Departamentit Amerikan të Shtetit dhe Qeverisë së Malit të Zi, që parashikon asgjësimin e tepricave të municioneve nga MM-ja dhe mbajtjen e tepricave të armëve dhe municioneve nga policia.⁶⁴

Maqedonia

Në raportin e saj kombëtar të vitit 2010 lidhur me zbatimin e Programit të Veprimit, Maqedonia shprehet se 'të gjitha armët e konfiskuara, të gjetura ose të sekuestruara shkatërrohen çdo vit' (Maqedonia, 2010, fq. 12). Sidoqoftë, Ligji i Maqedonisë për Armët përcakton që armët dhe municionet e konfiskuara gjatë një procedure penale apo një kundravajtjeje duhet t'i dërgohen MB-së. Ato përdoren për qëllime zyrtare nga MB-ja, MM-ja

ose ushtria. Armët e konfiskuara mund gjithashtu të shiten, nëse ato nuk korrespondojnë me pajisjet e MB-së, (SEESAC, 2004, fq. 358-59).

Pronarët të cilëve u është hequr leja për mbajtje armësh dhe armët dhe municionet e të cilëve janë konfiskuar, mund ta shesin armën e tyre brenda tre muajsh. Nëse pronari nuk mund t'i shesë armët brenda kohës së caktuar, ato i jepen një entiteti juridik të autorizuar për të tregtuar armë. Nëse entiteti i autorizuar nuk mund t'i shesë armët brenda gjashtë muajsh, ato i dërgohen autoritetit shtetëror kompetent.

Në vijim të kësaj, MB-ja është e autorizuar që të ngrejë një komision të veçantë, i cili do të vendosë për mënyrën e trajtimit të këtyre armëve dhe municioneve (SEESAC, 2004, fq. 358-59).

Ligji për Trajtimin e Mallrave të Sekuestruara dhe të Konfiskuara përfshin një pjesë lidhur me armët e vogla dhe të lehta, municionin dhe materialin eksploziv (Maqedonia, 2008, neni 58). Sipas këtij ligji, të gjitha mallrat e sekuestruara dhe të konfiskuara i dorëzohen agjencisë që administron mallrat e sekuestruara (neni 1). Nëse agjencia nuk ka kushtet e duhura për të magazinuar mallrat e sekuestruara, ato i dorëzohen MB-së dhe MM-së (neni 58.1). Armët dhe municionet e sekuestruara kategorizohen sipas funksionit të tyre. Nëse ato nuk mund të prokurohen në rrugë të ligjshme, ato asgjësohen (neni 58.2). Nëse qeveria bie dakord, armët dhe municionet funksionale mund t'u jepen ministrive të tjera ose organeve shtetërore për përdorim. Shembujt e marrësve përfshijnë MB-në, MM-në, policinë financiare, dhe organe të tjera që mund të mbajnë armë në mënyrë të ligjshme (neni 58.3). Përndryshe, armët duhet t'i dhurohen një muzeu. Nëse asnjë nga këto mundësi nuk është e përshtatshme, ato i shiten entiteteve juridike, të cilat përdorin armë, siç janë shoqatat e gjuetarëve (neni 58.4). Nëse armët nuk mund të shiten, ato asgjësohen (neni 59).

Këto rregullore tregojnë se (vetëm) armët që asgjësohen në mënyrë sistem-atike janë ato që nuk mund të përdoren më, ato përdorimi i të cilave është i ndaluar për civilët,⁶⁵ ato të cilat nuk mund t'i dhurohen një organi tjetër shtetëror ose një muzeu, dhe ato që nuk mund të shiten. Në praktikë, duket se Maqedonia ka arritur të eliminojë tepricat e armëve të saj ose duke i asgjësuar ato, ose duke i shpërndarë nëpër institucione të tjera shtetërore, duke mos shitur asnjë armë në jashtë vendit me procedurë tenderimi.⁶⁶

Rumania

Raporti kombëtar i Rumanisë i vitit 2003 lidhur me zbatimin e Programit të Veprimit thotë se nëse armët e vogla të sekuestruara dhe të konfiskuara nuk janë të përshtatshme për t'u tregtuar, ato asgjësohen nën mbikëqyrjen e një komisioni për asgjësimin (Rumani, 2003, fq. 8). Përndryshe, ato ofrohen për shitje në treg. Ligji i Rumanisë për Regjimin e Armëve të Zjarrit dhe Municionit parashikon që, kur anulohet një leje, të gjitha armët dhe municionet e mbajtura në përputhje me atë leje t'u dorëzohen autoriteteve policore për asgjësim. Të gjitha armët ushtarake të rimarra duhet t'u kthehen autoriteteve policore, prej të cilave janë marrë (SEESAC, 2004, fq. 629).

Serbia

Neni 25 i Ligjit të Serbisë për Armët dhe Municionet i autorizon zotëruesit e licencave të shfuqizuara dhe armëve të sekuestruara që t'i shesin armët brenda një viti. Armët dhe municionet të cilat nuk shiten brenda kësaj periudhe bëhen pronë e shtetit dhe duhet të magazinohen dhe ruhen nga MB-ja. Prandaj, Ministri i Brendshëm ngrë një komision të përbërë nga oficerë profesionistë të policisë për të bërë ekzaminimin e armëve dhe municioneve dhe për të identifikuar ato që duhen asgjësuar (SEESAC, 2004, fq. 827-28).⁶⁷ Në praktikë, autoritetet serbe identi-

fikojnë si teprica armët e sekuestruara dhe të konfiskuara. Sipas raportit kombëtar të Serbisë për zbatimin e Programit të Veprimit, këto armë asgjësohen (Serbia, 2006, fq. 6).

Slovenia

Në Slloveni, Departamenti i Çështjeve Administrative në MB menaxhon vetëm armët dhe municionet që janë dërguar, gjetur, sekuestruar ose konfiskuar në përputhje me Dekretin për Procedurën e Menaxhimit të Artikujve, Pronës dhe Sigurisë, ashtu siç është miratuar në datën 6 mars 2002 dhe ndryshuar e plotësuar në janar të vitit 2007 (Sllovenia, 2002; 2007). Dekreti përmban udhëzime lidhur me trajtimin e armëve të dorëzuara, të gjetura, të sekuestruara dhe të konfiskuara dhe përcakton sjelljen e policisë dhe njësie administrative lidhur me këto armë. Armët që u sekuestrohen civilëve mbahen nga MB-ja (Sllovenia, 2002, neni 7). Nëse sekuestrohen armë ushtarake:

deri në 5 armë ose pajisje dhe deri në 1,000 copë municione ushtarake [...] magazinohen brenda ministrisë përgjegjëse për punët e brendshme në ambiente të siguruara siç duhet. Sasi më të mëdha të armëve ushtarake, municione dhe pajisje apo armë më të mëdha ushtarake ruhen brenda ministrisë përgjegjëse për mbrojtjen (Sllovenia, 2007, neni 4).

Nëse pas një vendimi gjyqësor, artikujt nuk mund t'i kthehen pronarit, armët e ndaluara asgjësohen; armët e lejuara mund të klasifikohen për eliminim, dhurim, mbledhje të përhershme ose për nevojat operative të policisë, nëse i përmbushin kushtet për përdorim nga policia.⁶⁸ Armët e tjera, për të cilat nuk mund të sigurohen dokumente, shiten. 'Nëse shitja nuk është e mundur ose nëse shpenzimet për shitje e tejkalojnë vlerën e artikujve [...] gjykata tëhuhet të urdhërojë asgjësimin e artikujve ose dhurimin e tyre institucioneve publike, siç janë

për shembull muzetë (Sllovenia, 2002, nenet 9, 13). Sidoqoftë, Sllovenia raporton që në praktikë 95 për qind e të gjitha armëve të sekuestruara asgjësohen (Sllovenia, 2010, fq. 10). Asgjësimi i armëve (ushtarake), municioneve, dhe eksplozivëve të sekuestruar bëhet nga MB-ja ose MM-ja (Sllovenia, 2002, neni 14).

Përfundim

Kjo *Përmbledhje e Shkurtër* tregon se shtetet vendosin lidhur me tepricat e tyre sipas kushteve teknike, rezistencës së armëve dhe municionit, dhe nevojave që kanë për armë forcat e mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare. Sapo shtetet përcaktojnë se cilat rezerva janë të tepërta për nevojat kombëtare, ekzistojnë disa opsione për asgjësimin e tyre: shitja, dhurimi, asgjësimi, magazinimi, dhe përdorimi (për inventarë apo për qëllime trajnimit të ministrive të tjera dhe institucioneve shtetërore). Këto metoda asgjësimi përdoren nga vendet e Evropës Juglindore në nivele të ndryshme.

Për të asgjësuar armët e sekuestruara dhe të konfiskuara, vendet e Evropës Juglindore përdorin kryesisht tre mënyra: shitjen, shpërndarjen në ministrinë e tjera të tyre, dhe asgjësimin. Armët e sekuestruara dhe të konfiskuara, për të cilat ekziston dokumentacioni përkatës dhe të cilat nuk janë të ndaluara me ligj, shiten ose u dhurohen organeve të tjera shtetërore nëse armët përputhen me pajisjet që përdoren dhe nëse gjendja e tyre fizike e lejon një gjë të tillë. Politikat e Bullgarisë, Kroacisë, Maqedonisë, Malit të Zi, Rumanisë dhe Sllovenisë tregojnë se disa armë të sekuestruara dhe të konfiskuara përdoren në këtë mënyrë. Këto vende asgjësojnë vetëm armët e ndaluara, ato që kanë dalë jashtë përdorimit, dhe ato që janë prishur, sekuestruar ose konfiskuar. Nga ana tjetër, Bosnja dhe Hercegovina, ashtu si edhe Serbia, sipas relacioneve i asgjësojnë të gjitha armët e sekuestruara dhe të konfiskuara.



Një oficer i ushtrisë amerikane përgatit raketat SA-7A që do të shpërthehen në Bosnje dhe Hercegovinë, Mars 2004.
© Amel Emric/AP Photo

Praktika në Evropën Juglindore për asgjësimin e armëve të sekuestruara dhe të konfiskuara përputhet me Protokollin e OKB-së për Armët e Zjarrit, e cila përfshin edhe detyrimin për shkatërrimin e armëve të zjarrit, pjesëve të tyre, elementëve, dhe municionit, të cilat janë prodhuar në mënyrë të paligjshme dhe janë trafikuar nëse autoritetet nuk autorizojnë ndonjë formë tjetër asgjësimi. Një praktikë e tillë përputhet gjithashtu me Instrumentin e Gjurmimit Ndërkombëtar, që kërkon nga shtetet që të eliminojnë (ose të shënjojnë dhe të regjistrojnë) armët e vogla dhe armët e lehta të paligjshme të gjetura në territorin e tyre.

Pavarësisht prezumimit në favor të shkatërrimit që pasqyrohet në shumë prej instrumenteve të tjera ndërkombëtare dhe rajonale, politikat e vendeve të Evropës Juglindore

dominohen nga shitja dhe dhurimi i tepricave shtetërore të armëve dhe të municioneve tek shtetet e tjera. Në forumet ndërkombëtare, rajonale dhe nën-rajonale, shtetet kanë njohur qartë rëndësinë që ka asgjësimi i materialeve të tepërta si një metodë e parapëlqyer. Ashtu siç vërehet edhe në këtë Përmbledhje të Shkurtër, praktika shtetërore është më e larmishme. Disa vende i shohin tepricat e tyre më shumë si pasuri sesa si përgjegjësi apo shpenzime të mundshme duke favorizuar kështu shitjen dhe dhurimin e tyre. Nëse vendet e destinacionit të rezervave të tepërta nuk e kanë kapacitetin ose mjetet për t'i ruajtur këto artikuj, me to eksportohet edhe problemi i sigurimit dhe menaxhimit të materialeve. Përveç kësaj, kërkesa globale për armë dhe municion rezervë mund të dëmtojë vendimin e shteteve për të shkatërruar rezervat e tepërta. ■

Autori, Jasna Lararevic, falënderon Eric G. Berman, Pierre Gobinet, Aaron Karp, Sarah Parker, dhe Hans Risser për drejtimin dhe recensionin e dobishëm gjatë gjithë studimit dhe procesit të hartimit, si dhe Janis Grzybowski dhe Pilar Reina, asistentë-studiuues për Pyetësorin e Armëve të Vogla (Small Arms Survey), për mbështetjen e tyre në fushën kërkimore.

Shënime

- 1 Përkufizimi i armëve të vogla dhe të lehta në këtë Përmbledhje të Shkurtër përfshin si armët e stilit ushtarak ashtu edhe armët e zjarrit për përdorim komercial. Ky përkufizim është në përputhje me udhëzimet e përcaktuara në Raportin e Panelit të Ekspertëve Qeveritarë mbi Armët e Vogla, i vitit 1997 (UNGA, 1997). Armët e vogla përfshijnë revolverët dhe pistoletat me vetëmbushje, pushkët dhe karabinat, pushkët sulmuese, mitralozët, mitralozët e lehtë; armët e lehta përfshijnë mitralozët e rëndë, granatëhedhësit e montuar nën tytën e armës, antitankët dhe kundërajrorët

- e lëvizshëm, armët e zjarrit pa zbrapsje, hedhësit e lëvizshëm të raketave anti-tank dhe kundërajrorët, si dhe mortajat (e kalibrit nën 100mm); municionet dhe eksplozivët përfshijnë fishekët e armëve të vogla, predhat dhe raketat për armët e lehta, kontenierët e lëvizshëm të raketave, dhe predha për raketahedhësit, antiajrorët dhe antitankët, granatat (që përdoren kundër njerëzve) dhe granatat antitank, minat e tokës, dhe eksplozivët.
- 2 Gjashtë shtete anëtare të Kombeve të Bashkuara kanë qenë ish-Republika Socialiste Federale të Jugosllavisë: Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia dhe Sllovenia.
 - 3 Iniciativa RASR fokusohet të të gjashtë anëtarët e ish-Jugosllavisë, plus tre shtete të rajonit që janë anëtarësuar në NATO kohët e fundit: Shqipëria, Bullgaria, dhe Rumania (edhe dy republika ish-jugosllave janë anëtarësuar në NATO: Kroacia dhe Sllovenia). Për më shumë informacion mbi RASR-in, shihni RASR (p.d).
 - 4 Kjo Përmbledhje e Shkurtër përfaqëson studimin e parë ndër shumë të tjerë të planifikuar për të mbështetur këtë iniciativë.
 - 5 Seksionet dy dhe tre përdorin informacion të mbledhur nga burimet kryesore, si p.sh. raporti kombëtar mbi zbatimin e Programit të Kombeve të Bashkuara i Veprimeve për të Parandaluar, Luftuar dhe Asgjësuar Tregtinë e Paligjshme të Armëve të Vogla dhe të Lehta në të Gjitha Aspektet e saj, planet kombëtare të veprimit, dokumente zyrtare qeveritare, rregulloret, manualët, dhe ligjet kombëtare, si dhe intervistat dhe korrespondenca me zyrtarë të qeverisë dhe aktorë të tjerë. Në rastet kur ishte e pamundur të sigurohej informacion parësor, studimi i referohet burimeve dytësore.
 - 6 Disa shtete mund të vendosin që gjithmonë ekziston një 'nevojë' dhe se një pjesë e materialit të saj është e tepërt. Në lidhje me diskutimet mbi vlerësimin e tepriçës shihni, për shembull, Bevan (2008) dhe Karp (2009; 2010).
 - 7 Marrëveshja e Wassenaar-it ka 40 shtete pjesëmarrëse, nga të cilat Bullgaria, Kroacia, Rumania, dhe Sllovenia janë të përfshira në Iniciativën RASR.
 - 8 Marrëveshja e Wassenaar-it nuk inkurajon shitjen më tepër se shkatërrimin. Qëllimi i kësaj marrëveshje është të sigurojë udhëzime mbi praktikën më të mira për transferimin e armëve të vogla dhe të lehta të tepërta, në rastet kur nuk shkatërrohen.
 - 9 Ky seksion shqyrton vetëm normat rajonale të përdorshme në Evropën Juglindore.
- Normat e tjera janë miratuar nga Organizata e Shteteve Amerikane, Komuniteti Ekonomik i Shteteve të Afrikës Perëndimore, dhe Komuniteti i Zhvillimit të Afrikës Jugore; këto norma janë më të rrepta sesa normat e aplikuara në Evropë.
- 10 Shihni edhe udhëzues të tjerë, si Meek dhe Stott (2004); BICC dhe SAND (2000); dhe Hughes-Wilson dhe Wilkinson (2001).
 - 11 PNUD-i dhe Mekanizmat e Koordinimit të Veprimeve mbi Armët e Vogla (Coordinating Action on Small Arms Mechanisms) janë në proces zhvillimi të Standardeve Ndërkombëtare të Kontrollit të Armëve të Vogla (ISACS). Këto modele nuk janë praktikuar më të mira, por duhen konsideruar si udhëzues. Ato kanë për qëllim të informojnë agjencitë dhe njësitë e tjera shtetërore që merren me çështjen e armëve të vogla dhe të lehta. Dy nga 25 modulet trajtojnë çështjen e shkatërrimit. Njëri i dedikohet shkatërrimit të armëve dhe tjetri shkatërrimit të municioneve.
 - 12 Në vitin 2006, Instituti i Kombeve të Bashkuara për Kërkimet mbi Çarmatimin (UN Institute for Disarmament Research), Universiteti i Bradford-it, dhe SEESAC krijuan një program kompjuterik për të bërë analizën e kostove dhe fitimit nga shkatërrimi i armëve të vogla dhe të lehta në krahasim me magazinimin e tyre. Për më shumë informacion, shihni Turner (2006).
 - 13 Përzgjedhja e teknikës më të përshtatshme të shkatërrimit varet nga një sërë faktorësh. Për më shumë hollësi, shihni Wilkinson (2006, fq. 268).
 - 14 Korrespondenca e autorit me Maj. Shkelqim Sina, specialist armësh, Forcat e Armatosura Shqiptare (FASH), 23 korrik 2010.
 - 15 Për më shumë informacion, shihni Wilkinson (2006, fq. 268).
 - 16 Intervista e autorit me Radovan Ljumovic, Drejtorja e Policisë së Malit të Zi, 10 gusht 2010.
 - 17 Intervista e autorit me Igor Milic, armëpunues, magazina e policisë qendrore, Podgoricë, Mali i Zi, 10 gusht 2010.
 - 18 Disa shembuj janë Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, dhe Serbia.
 - 19 Procesi i Bashkëpunimit i Evropës Juglindore (South-East European Cooperation Process) përfshin këto shtete: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Greqia, Maqedonia, Moldavia, Mali i Zi, Rumania, Serbia, dhe Turqia.
 - 20 Siç ilustron në tabelën 1, kjo nuk aplikohet në rastin e Sllovenisë, Ministria e Mbrojtjes së së cilës nuk ofroi asnjë informacion për këtë studim në lidhje me procedurat apo metodat e preferuara të asgjësimit të municioneve të tepërta shtetërore.
 - 21 Janë katër organizata rajonale dhe ndërkombëtare që lehtësojnë pjesën më të madhe të shkatërrimit të armëve të vogla dhe municioneve: BE-ja, NATO, OSBE-ja, dhe Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (PNUD) së bashku me qeverinë e SHBA-së dhe të vendeve të tjera.
 - 22 Embargot e Kombeve të Bashkuara, kufizimet e BE-së, zhdukja e tregjeve tërheqëse, ngopja e tregjeve me disa lloje armësh, dhe konkurrenca e fuqishme ndërkombëtare janë faktorët që kufizojnë më shumë shitjen e tepriçave. Një nga arsytet e çmimit të ulët të municioneve mund të jetë rritja e kapacitetit të prodhimit gjatë viteve të fundit. Intervista e autorit me Maj. Shkelqim Sina, specialist armësh, Forcat e Armatosura Shqiptare (FASH), 23 korrik 2010; Tog.Kol. Dragoslav Vuksanovic, Ministria e Mbrojtjes, Podgoricë, 5 Korrik 2010; Tog.Kol. Vukadin Tomasevic, Ministria e Mbrojtjes, Podgoricë, Mali i Zi, 6 Korrik 2010.
 - 23 Nuk është bërë asnjë përpjekje për të vlerësuar praktikën aktuale shtetërore apo masën e zbatimit të këtyre politikave dhe direktivave, apo shkallën e përmeshjes së objektivave të tyre; megjithatë, kur ka pasur informacion është përfshirë edhe praktika shtetërore.
 - 24 Korrespondenca e autorit me Momir Brajic, Ministria e Jashtme, Bosnja dhe Hercegovina, 16 korrik 2010.
 - 25 Korrespondenca e autorit me Momir Brajic, Ministria e Jashtme, Bosnja dhe Hercegovina, 16 korrik 2010; intervista me Brig. Mladen Marinkovic, Forcat e Armatosura të Bosnje-Hercegovinës, 4 gusht 2010.
 - 26 Moratoriumi për Ndërprerjen e Shitjes së Armëve të Vogla dhe Municioneve, themeluar në qershor 2004 në Bosnje-Hercegovinë, u ndërpre nga qeveria e Bosnje-Hercegovinës në 31 dhjetor 2005. Shitjet e ngrira sipas këtij moratoriumi u lejuan të përfundoheshin edhe pas përfundimit të tij. Intervista e autorit me Brig. Mladen Marinkovic, Forcat e Armatosura të Bosnje-Hercegovinës, 4 gusht 2010; Turner (2006, fq. 15). 31 dhjetor 2005. Shitjet e ngrira sipas këtij moratoriumi u lejuan të përfundoheshin edhe pas përfundimit të tij. Intervista e autorit me Brig. Mladen Marinkovic, Forcat e Armatosura të Bosnje-Hercegovinës, 4 gusht 2010; Turner (2006, fq. 15).

- 27 Shitjet ose dhurimet në destinacione të tjera kanë ndodhur para vitit 2009 (Kauer, 2007, fq. 91).
- 28 Intervista e Autorit me Brig. Mladen Marinkovic, Forcat e Armatosura të Bosnje Hercegovinës, 4 Gusht 2010.
- 29 Në vitin 2003, magazinat e Bullgarisë kishin 160,000 tonë municione; 7,000 tonë prej të cilave mbaheshin në qiell të hapur. Në vitin 2005, 67,000 tonë u deklaruan si teprica (Nikolov, 2010).
- 30 Bullgaria po përcakton një procedurë të re lidhur me shitjet e municioneve të braktisura. Korrespondenca e autorit me Lt.Col. Nikolay Nikolov, specialist i armatimeve dhe asistent i Zëvendësministrit të Mbrojtjes, Bullgari, 3 Gusht 2010.
- 31 Raporti kombëtar i Kroacisë për zbatimin e Programit të Kombeve të Bashkuara të Veprimeve për të Parandaluar, Luftuar dhe Asgjësuar Tregtinë e Paligjshme të Armëve të Vogla dhe të Lehta në të Gjitha Aspektet e saj tregon që, nga gjithë rezervat totale, armët e vogla dhe armët e lehta më të vjetra do të deklarohen si teprica (Kroaci, 2010, fq. 13).
- 32 Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Brendshme e Kroacisë sipas relacioneve i kanë ambientet e tyre për asgjësim (SEESAC, 2006c, fq. 49).
- 33 Disa studime të mëparshme tregojnë se jo të gjitha tepricat e armëve në Kroaci janë caktuar për asgjësim, pasi duket se magazinimi i tepricave të armëve ka kosto më të ulët për qeverinë sesa asgjësimi i tyre. Numri i asgjësimeve është rritur, por shumë teprica ruhen ende. (IA, 2003, fq. 6). Në të vërtetë, asgjësimi i armëve nuk është bërë përparësi për qeverinë kroate. Edhe pse ka pasur aktivitete asgjësuese, ato masa nuk janë pjesë e programi të përgjithshëm sistematik asgjësues (SEESAC, 2006c, fq. 49; 2006b, fq. 41).
- 34 Një reformë e vitit 2005 riorganizoi policinë si një institucion më vete, të pavarur nga MB-ja dhe ministritë e tjera. Kontrolli kufitar u përfshi gjithashtu në drejtorinë e re të policisë.
- 35 Çmilitarizimi dhe asgjësimi i mbështetur nga OSBE-ja dhe nga PND-i u ndërpre përkohësisht si mungesë e mbështetjes së pamjaftueshme të donatorëve. Shtetet e Bashkuara janë donatori i vetëm që ka mbetur e që financon një program të madh asgjësimi, përfshirë municionet nga MM-ja dhe armët dhe municionet nga policia.
- 36 Intervistat e autorit me Lt.Col. Dragoslav Vuksanovic, MM, Podgoricë, 5 korrik 2010, dhe Lt.Col. Vukadin Tomasevic, MM, Podgoricë, 6 korrik 2010.
- 37 Intervista e autorit me Lt.Col. Vukadin Tomasevic, MM, Podgoricë, 6 korrik 2010.
- 38 Intervista e autorit me Lt. Col. Vukadin Tomasevic, MM, Podgoricë, 27 gusht 2010.
- 39 Intervista e autorit me Radovan Ljumovic, Drejtoria e Policisë, Mali i Zi, 25 gusht 2010.
- 40 Disa prej ambienteve ku mbahen tepricat e përdorura nga policia në qendër të Podgoricës janë të mbushura plot me armë dhe municione. Nuk ka zonë sigurie rreth ambientit dhe hapësira midis materialit dhe tavanit është e pamjaftueshme. Intervistat e autorit me disa aktorë kryesorë, Podgoricë, 5–7 korrik dhe 9–13 gusht 2010.
- 41 Këto raketa tokë-qiell u asgjësuan në kuadër të një marrëveshjeje teknike midis Departamentit Amerikan të Shtetit dhe Qeverisë së Malit të Zi që përfshin çmilitarizimin e armëve të vogla dhe të lehta specifike dhe lloje të ndryshme municionesh në Mal të Zi. Marrëveshja përcakton që lëndët eksplozive të rimarra duhet të ristrukturohen për t'u përdorur në lëndët eksplozive komerciale dhe që 'hekurishtet e mbetura nga procesi i asgjësimit t'i ofrohen fabrikës së kontraktuar si pjesë e pagesës vetëm nëse MM-ja nuk dëshiron ta mbajë atë (USDoS, 2007, neni B.8).
- 42 Intervistat e autorit me disa aktorë kryesorë, Podgoricë, 5–7 korrik dhe 9–13 gusht 2010.
- 43 Intervista e autorit me Radovan Ljumovic, drejtoria e policisë, Mal i Zi, 25 gusht 2010.
- 44 Dusko Ivanov, Këshilltar i Shtetit dhe pika kombëtare e kontaktit për armët e vogla dhe të lehta në MB-në e Maqedonisë, raporton se nuk ka procedura të caktuara të shkruara apo ndonjë rregullore për mënyrën e trajtimit të tepricave të armëve nga MM-ja ose nga MB-ja. Korrespondenca e autorit, 26 dhe 28 korrik 2010.
- 45 Intervista e autorit me Dusko Ivanov, Këshilltar i Shtetit dhe pika kombëtare e kontaktit për armët e vogla dhe të lehta në MB-në e Maqedonisë, 26 dhe 28 Korrik 2010. Kjo pikë u konfirmua gjithashtu edhe nga literatura dytësore; shih, për shembull, SEESAC (2006c, fq. 57).
- 46 Në kohën kur është shkruar raporti, Shtetet e Bashkuara po nxirrnin një program shumëdimensional, që përfshin trajnime mbi menaxhimin e tepricave nga personeli ushtarak dhe çmilitarizimin e armëve dhe municioneve nga MM-ja.
- 47 Marrësit publikë mund të përfshijnë rojat e burgjeve të Ministrisë së Drejtësisë ose policinë e pyjeve të Ministrisë së Bujqësisë (Faltas, 2008, fq. 94).
- 48 Intervista e autorit me Administrimin e Teknologjive të Mbrojtjes, MM, Serbi, 26 Gusht 2010.
- 49 Të paktën midis viteve 2004 dhe 2006, tepricat [armët e vogla dhe të lehta] të caktuara nga Ministria e Mbrojtjes iu ofruan më pas për shitje, përmes një procedure tenderimi, kompanive të ndryshme ish-shtetërore të armëve siç është SDPR Yugoimport, që kishin licencat e duhura për shitjen e tepricave tek tregtarët apo komisionerët' (Griffiths, 2008, fq. 178).
- 50 MM nuk i publikon direktivat e përdorura për të marrë vendime lidhur me asgjësimin e tepricave.
- 51 Korrespondenca e autorit me S. E. Willason, Drejtor, Dega e Mbështetjes për Municionet, Agjencia e Furnizimit dhe Mirëmbajtjes në NATO (Maintenance and Supply Agency), Luksemburg, 17 shtator 2010.
- 52 Korrespondenca e autorit me Maj. Shkelqim Sina, specialist armësh, FASH, 23 korrik 2010, 21 korrik 2010.
- 53 Shihni gjithashtu SEESAC (2004, fq. 61).
- 54 Korrespondenca e autorit me Maj. Shkelqim Sina, specialist armësh, FASH, 23 korrik 2010, dhe intervista në 21 korrik 2010.
- 55 Korrespondenca e autorit me Jurij Žerovec dhe Gregor Kaplan, Departamenti i Politikave të Sigurisë, MPJ, Slloveni, 29 korrik 2010.
- 56 Korrespondenca e autorit me Filip Tunjic, Departamenti për Bashkëpunimin Shumëpalësh dhe Diplomacinë për Mbrojtjen, MM, Slloveni. 28 shtator 2010.
- 57 Kjo pjesë nuk mbulon armët e mbledhura përmes programeve kombëtare dhe ndërkombëtare të sponsorizuara për mbledhjen e armëve.
- 58 Sllovenia nuk specifikon nëse armët e sekuestruara dhe të konfiskuara mund t'i dhurohen muzeve apo vendeve të tjera.
- 59 Intervista e autorit me Brig. Mladen Marinkovic, Forcat e Armatosura të Bosnje Hercegovinës, 4 gusht 2010.
- 60 Korrespondenca e autorit me Hans Risser, këshilltar i lartë dhe menaxher i programit, Siguria Njerëzore, UNDP, Kroaci, 13 gusht 2010.
- 61 Intervista e autorit me Igor Milic, armëpunues, depoja qendrore e policisë, Podgoricë, 10 gusht 2010.
- 62 Intervista e autorit me Radovan Ljumovic, drejtoria e policisë, Mali i Zi, 10 gusht 2010.
- 63 Intervista e autorit me Radovan Ljumovic, drejtoria e policisë, Mali i Zi, 25 gusht 2010.
- 64 Intervista e autorit me Radovan Ljumovic, drejtoria e policisë, Mali i Zi, 10 gusht 2010,

- dhe me Lt.Kol. Douglas M. Faherty, Atashe i mbrojtjes dhe ushtrisë, Ushtria e SHBA-së, dhe me Aleksandar Mrdak, asistent Atashe i mbrojtjes, SHBA, Podgoricë, 12 gusht 2010.
- 65 Korrespondenca e autorit me Dusko Ivanov, këshilltar i shtetit dhe pika e kontaktit për armët e vogla dhe të lehta, MB, Maqedoni, 28 korrik 2010.
- 66 Intervista e autorit me Dusko Ivanov, Këshilltar i Shtetit dhe pika e kontaktit për armët e vogla dhe të lehta, MB, Maqedoni, 22 korrik 2010.
- 67 Korrespondenca e autorit me Zorica Loncar Kasalica, Këshilltare e Shefit të Policisë, 8 shtator 2010.
- 68 Korrespondenca e autorit me Jurij Žerovec dhe Gregor Kaplan, Divizioni i Politikave të Sigurisë, Ministria e Punëve të Jashtme, Slloveni, 29 korrik 2010.
- ## Bibliografia
- Bevan, James, bot. 2008. *Conventional Ammunition in Surplus: A Reference Guide*. Gjenevë: Small Arms Survey.
- Bevan, James dhe Adrian Wilkinson. 2008. 'Glossary of Conventional Ammunition: Terminology.' Në Bevan James, bot. *Conventional Ammunition in Surplus: A Reference Guide*. Gjenevë: Small Arms Survey.
- BICC dhe SAND (Bonn International Center for Conversion and Program on Security and Development, Monterey Institute of International Studies). 2000. *Tackling Small Arms and Light Weapons: A Practical Guide for Collection and Destruction*. Bonn dhe Monterey: BICC dhe SAND. <http://sand.mii.edu/projects/fieldguide/field_guide_final_en.pdf>
- Bosnja dhe Hercegovina. 2008. Agreement on Final Disposal of all Rights and Obligations over Movable Property That Will Continue to Serve Defence Purposes (përkthimi nuk është rishikuar). Sarajevë: Presidenca e Bosnjës dhe Hercegovinës. Janar.
- . 2010. *Reporting and Implementation of the United Nations Programme of Action to Prevent, Combat and Eradicate the Illicit Trade in Small Arms and Light Weapons (SALW) in All Its Aspects in Bosnia and Herzegovina for the Year 2009*. Sarajevë: Ministria e Punëve të Jashtme. <<http://www.poa-iss.org/CountryProfiles/CountryProfileInfo.aspx?CoI=25&pos=30>>
- Bullgaria. 2010. *National Report on Bulgaria's Implementation of the International Instrument Enable States to Identify and Trace, in a Timely and Reliable Manner, Illicit Small Arms and Light Weapons and the 2001 UN Programme of Action to Prevent, Combat and Eradicate the Illicit Trade in Small Arms and Light Weapons in All Its Aspects*. Sofja: Ministria e Punëve të Jashtme. <<http://www.poa-iss.org/CountryProfiles/CountryProfileInfo.aspx?CoI=30&pos=30>>
- Faltas, Sami. 2008. 'Bulgaria and Romania: Quick Start, Ambiguous Progress.' *Contemporary Security Policy*, Vëll. 29, Nr. 1, f. 78–102.
- Griffiths, Hugh. 2008. 'Serbia: Choosing between Profit and Security.' *Contemporary Security Policy*, Vëll. 29, Nr. 1, f. 175–201.
- Hughes-Wilson, John dhe Adrian Wilkinson. 2001. *Safe and Efficient Small Arms Collection and Destruction programmes: A Proposal for Practical Technical Measures*. New York: Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim. Korrik. <http://www.reliefweb.int/library/documents/2001/advocacy/undp_erd_smallarms.pdf>
- IA (International Alert). 2003. *Monitoring the Implementation of Small Arms Controls (MISAC): Small Arms Control in Croatia*. Londër: IA. <http://www.internationalalert.org/pdfs/MISAC_CroatiaStudy.pdf>
- IMAS (International Mine Action Standards). 2003. *IMAS 04.10: Glossary of Mine Action Terms, Definitions and Abbreviations*, botimi i 2-të. Nju Jork: United Nations Mine Action Service. 1 January. <http://www.mineactionstandards.org/IMAS_archive/Amended/Amended3/IMAS_04.10_Edition2_Jan2008rev.pdf>
- Karp, Aaron. 2008. 'A Semi-automatic Process? Identifying and Destroying Military Surplus.' Në Small Arms Survey. *Small Arms Survey 2008: Risk and Resilience*. Cambridge: Cambridge University Press, f. 78–111.
- . 2009. 'Man, the State, and War: The Three Faces of Small Arms Disarmament.' Në Small Arms Survey. *Small Arms Survey 2009: Shadows of War*. Cambridge: Cambridge University Press, f. 159–91.
- , bot. 2010. *The Politics of Destroying Surplus Small Arms: Inconspicuous Disarmament*. Nju Jork: Routledge.
- Kauer, Erwin. 2007. 'Weapons Collection and Destruction Programmes in Bosnia and Herzegovina.' Në Peter Hazdra, bot. *Small Arms—Big Problem: A Global Threat to Peace, Security and Development*. Vienna: Akademia Kombëtare e Mbrojtjes, Ministria e Mbrojtjes dhe e Sporteve e Austrisë, f. 65–81. <http://www.bmlv.gv.at/pdf_pool/publikationen/small_arms_weapons_collection_destruction_e_kauer.pdf>
- Kroacia. 2002. 'Pravilnik o prodaji neper-spektivnih sredstava naoružanja i vojne opreme ministarstva obrane i oruzanih snaga republike hrvatske.' *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kroacisë* 33/02. Zagreb: Ministria e Mbrojtjes.
- . 2006. *The Croatian Armed Forces Long-Term Development Plan 2006–2015*. Zagreb: Ministria e Mbrojtjes. Qershor.
- . 2009. *Nacionalna Strategija i Akcijski Plan za Kontrolu Malog i Lakog Oruzja*. Zagreb: Qeveria e Kroacisë. Shtator.
- . 2010. *Report on Implementation of the United Nations Programme of Action to Prevent, Combat and Eradicate the Illicit Trade in Small Arms and Light Weapons in All Its Aspects*. Zagreb: Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Integritimit Evropian. <<http://www.poa-iss.org/CountryProfiles/CountryProfileInfo.aspx?CoI=50&pos=30>>
- Këshilli i BE-së. 2002. Council Joint Action on the European Union's Contribution to Combating the Destabilising Accumulation and Spread of Small Arms and Light Weapons and Repealing Joint Action 1999/34/CFSP ('Council Joint Action'). 2002/589/CFSP of 12 July. Riprodhuar në *Official Journal of the European Communities*, Nr. L 191/1. <<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2002:191:0001:0004:EN:PDF>>
- Mali i Zi. 2005. *Strategija za kontrolu i smanjenje lakog i malokalibarskog naoružanja*. Podgoricë: Ministria e Punëve të Brendshme. Korrik.
- . 2009. Zakon o Drzavnoj Imovini (Law on State Property — përkthim jozyrtar). Podgoricë: Kuvendi i Malit të Zi. Shkurt.
- . 2010. *Stretegijski Pregled Odrbane Crne Gore*. Podgoricë: Ministria e Mbrojtjes. Qershor.
- Maqedonia. 2008. Ukaz za proglašuvanje na zakonot za upravuvanje so konfiskuvan imot, imotna korist i odzemeni predmeti vo krivicna i prekrsočna postapka (Law on Confiscated Property, Use of Property, and Seized Goods in Criminal Cases and Proceedings — përkthim jozyrtar). *Gazeta Zyrtare e Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, Nr. 98. Skopje: Makedonia. 4 August.
- . 2010. *2010 Report on Implementation of the United Nations Programme of Action to Prevent, Combat and Eradicate the Illicit Trade in Small Arms and Light Weapons in All Its Aspects*. Shkup: Maqedoni. 4 March. <<http://www.un-casa.org/CASACountryProfile/PoANationalReports/2010@116@2010%2003%2008%20National%20Report.pdf>>
- Meek, Sarah dhe Noel Stott. 2004. *A Guide to the Destruction of Small Arms and Light Weapons: The Approach of the South African National Defence Force*. Gjenevë: United

- Nations Institute for Disarmament Research. <http://www.unidir.org/bdd/fiche-ouvrage.php?ref_ouvrage=92-9045-162-9-en>
- NATO. 2010. 'Equipping and Sustaining the Afghan National Security Forces.' Fact sheet. Bruksel: NATO Equipment Donation Support Programme. Janar. <<http://www.isaf.nato.int/images/stories/File/factsheets/Jan%20202010-Fact%20Sheet%20ANA%20Equip%20Prog.pdf>>
- Nikolov, Nikolay. 2010. 'Dealing with Explosive Remnants of War and Redundant Ammunitions: Bulgarian Experience.' PowerPoint prezantimi në Konventën e Kombeve Të Bashkuara për Protokollin V për Disa Armë të Caktuara Konvencionale dhe Mbetjeve të Eksplozivëve Nga Lufta. Gjenevë, 21 prill.
- OSBE (Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë). 2000. *OSCE Document on Small Arms and Light Weapons*. FSC.JOUR/314. Vjenë: Forumi për Siguri dhe Bashkëpunim. 24 nëntor. <http://www.osce.org/documents/fsc/2000/11/1873_en.pdf>
- . 2003a. *OSCE Document on Stockpiles of Conventional Ammunition*. DOC/1/03. Vjenë: Forumi për Siguri dhe Bashkëpunim. 19 nëntor. <http://www.osce.org/documents/fsc/2003/11/1379_en.pdf>
- . 2003b. 'Best Practice Guide on National Procedures for the Destruction of Small Arms and Light Weapons.' Në OSBE. *OSCE Handbook of Best Practices on Small Arms and Light Weapons*. Vjenë: OSBE. Shtator. <http://www.osce.org/publications/fsc/2003/12/13550_29_en.pdf>
- . 2004. *OSCE Principles for Export Controls of Man-Portable Air Defence Systems (MANPADS)*. Vendimi Nr. 3/04. Vjenë: Forumi për Siguri dhe Bashkëpunim. 26 maj. <http://www.osce.org/documents/fsc/2004/05/2965_en.pdf>
- . 2008. 'Best Practice Guide on the Destruction of Conventional Ammunition.' Në OSBE. *OSCE Handbook of Best Practices on Conventional Ammunition*. Vjenë: OSBE.
- dhe UNDP (Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim). 2007. *Annex C to Programme Framework Document: Government of Montenegro—SALW (Conventional Ammunition) Demilitarization*. <<http://www.undp.org.me/ijr/projects/Montenegro%20Demilitarization/Annex%20C%20ProDoc%20Ammunition%20Demilitarization.pdf>>
- RASR (Regional Approach to Stockpile Reduction). P.d. RASR ueb faqja. <<http://www.rasrinitiative.org>>
- Rumania. 2003. *Report on Implementation of the Programme of Action to Prevent, Combat and Eradicate the Illicit Trade in Small Arms and Light Weapons (SALW) in All Its Aspects*. Bukuresht: Qeveria e Rumanisë. Qershor. <<http://www.un-casa.org/CASACountryProfile/PoANationalReports/2003@162@romania.pdf>>
- . 2005. Hotarëa e Guvernului nr. 1470/2005 (Governmental Decision 1470/2005: Decision for the Approval of the Guidelines Concerning the Sale of the Goods Administered by the Ministry of Defence — përkthim jozyrtar). *Gazeta Zyrtare e Rumanisë*, Nr. 1109. 8 dhjetor. Bukuresht: Qeveria e Rumanisë.
- SEEC (South-East European Cooperation Process). 2008. *Joint Statement*. Takimi i ministrave të mbrojtjes së shteteve të Evropës Juglindore, Sofje, Bulgaria. 11 mars. <<http://www.chairmanship.mfa.md/img/seecp/joint-statement-20080311.doc>>
- SEESAC (South Eastern and Eastern Europe Clearinghouse for the Control of Small Arms and Light Weapons). 2004. *South Eastern Europe: Regional Arms Law Compendium*. Beograd: SEESAC.
- . 2006a. *Guide to Regional Micro-Disarmament Standards/Guidelines (RMDSG) and SALW Control Measures*. Beograd: SEESAC. <<http://www.seesac.org/resources/standards-rmdsg/1/>>
- . 2006b. *Analysis of National Legislation on Arms Exports and Transfers in the Western Balkans*. Beograd: SEESAC.
- . 2006c. *SALW Survey of Croatia*. Beograd: SEESAC. <http://www.bicc.de/uploads/pdf/publications/other/small_arms_seesac/croatian-survey-eng.pdf>
- . 2009. 'Bosnia to Donate Surplus Weapons to Afghan Army.' SALW Media Monitoring. 31 tetor. <<http://www.seesac.org/salw-media-monitoring/1/>>
- Serbia. 2006. *Report on the Implementation of the United Nations Programme of Action to Prevent, Combat and Eradicate the Illicit Trade in Small Arms and Light Weapons in All Its Aspects for 2005/2006*. Nju Jork: Misioni i Përhershëm i Serbisë në Kombet e Bashkuara. 27 dhjetor. <<http://www.un-casa.org/CASACountryProfile/PoANationalReports/2006@169@Serbia.pdf>>
- . 2010. 'Strategy on Small Arms and Light Weapons Control in the Republic of Serbia for the Period 2010–2015' (përkthim jozyrtar). *Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë* Nr. 1409. Beograd: Qeveria e Serbisë. 28 maj. <<http://www.seesac.org/uploads/SALW%20STRATEGY%20English%20unofficial%20version.pdf>>
- Serbia dhe Mali i Zi. 2004. *Report of Serbia and Montenegro on the Implementation of the UN Programme of Action to Prevent, Combat and Eradicate the Illicit Trade in Small Arms and Light Weapons in All Its Aspects*. Beograd: Qeveria e Serbisë dhe e Malit të Zi. <<http://www.un-casa.org/CASACountryProfile/PoANationalReports/2004@169@SerbiaandMontenegro.pdf>>
- Shqipëria. p.d.a. Plan of Action for the Elimination of Excess Ammunition in the Armed Forces of the Republic of Albania 2009–15. Tiranë: Ministria e Mbrojtjes.
- . p.d.b. *Resume of the Albanian Action Plan*. Tiranë: Ministria e Mbrojtjes.
- Slovenia. 2002. Uredbo o postopku upravljanja z zasezenimi predmeti, premozenjem in varscinami (Decree on the Management Procedure of Seized Items, Property and Security — përkthim jozyrtar). *Gazeta Zyrtare e Republikës së Sllovenisë*, Nr. 22/02. Lubjanë: Republika e Sllovenisë.
- . 2007. 'Uredbo o spremembah in dopolnitvah Uredbe o postopku upravljanja z zasezenimi predmeti, premozenjem in varscinami (Decree Amending and Supplementing the Decree on the Management Procedure of Seized Items, Property and Security — përkthim jozyrtar). *Gazeta Zyrtare e Republikës së Sllovenisë*, Nr. 8/07. Lubjanë: Republika e Sllovenisë.
- . 2008. *Report on Implementation of the United Nations Programme of Action to Prevent, Combat and Eradicate the Illicit Trade in Small Arms and Light Weapons in All Its Aspects*. Lubjanë: Ministria e Punëve të Jashtme. Prill. <<http://www.poa-iss.org/CountryProfiles/CountryProfileInfo.aspx?CoI=174&pos=30>>
- . 2010. *Report on Implementation of the United Nations Programme of Action to Prevent, Combat and Eradicate the Illicit Trade in Small Arms and Light Weapons in All Its Aspects*. Lubjanë: Ministria e Punëve të Jashtme. Shkurt. <<http://www.un-casa.org/CASACountryProfile/PoANationalReports/2010@174@2010%2002%2026%20-%20Report.pdf>>
- SSEE (Stability Pact for South Eastern Europe). 2006. *Combating Proliferation and Impact of Small Arms and Light Weapons: Stability Pact for South Eastern Europe—Regional Implementation Plan (Rishikuar 2006)*. 16 maj. <http://www.stabilitypact.org/salw/sp_rip_2006.pdf>
- Turner, Mandy. 2006. *Costs of Disarmament: Cost Benefit Analysis of SALW Destruction versus Storage*. Gjenevë: United Nations Institute for Disarmament Research. <<http://www.unidir.org/pdf/ouvrages/pdf-1-92-9045-184-X-en.pdf>>

- Kombet e Bashkuara. 2001. Programme of Action to Prevent, Combat and Eradicate the Illicit Trade in Small Arms and Light Weapons in All Its Aspects ('Programme of Action'). A/CONF.192/15 of 20 July. <<http://www.un.org/events/smallarms2006/pdf/192.15%20%28E%29.pdf>>
- UNDDA (United Nations Department for Disarmament Affairs). 2001. *A Destruction Handbook: Small Arms, Light Weapons, Ammunition and Explosives*. Nju Jork: UNDDA. <<http://www.un.org/spanish/Depts/dda/desthbk.pdf>>
- UNGA (United Nations General Assembly). 1997. *Report of the Panel of Governmental Experts on Small Arms*. A/52/298 of 27 gusht.
- . 1999. *Report of the Group of Governmental Experts on Small Arms*. A/54/258 of 19 gusht.
- . 2000. General and Complete Disarmament. A/RES/54/54 of 10 janar.
- . 2001. Protocol against the Illicit Manufacturing of and Trafficking in Firearms, Their Parts and Components and Ammunition, supplementing the United Nations Convention against Transnational Organized Crime ('Firearms Protocol'). A/RES/55/255 of 8 qershor.
- . 2005a. Rezoluta 60/74 e miratuar më 8 dhjetor. A/RES/60/74 of 11 janar 2006.
- . 2005b. International Instrument to Enable States to Identify and Trace, in a Timely and Reliable Manner, Illicit Small Arms and Light Weapons. A/CONF.192/15 of 8 dhjetor.
- . 2006. Rezoluta 61/72 e miratuar më 6 dhjetor. A/RES/61/74 of 3 janar 2007. <[http://disarmament.un.org/vote.nsf/e9e05f9ef74d8c7f05256705006e0a60/20f8a43e421379938525720a005e0b04/\\$FILE/A%20RES%2061%2074.pdf](http://disarmament.un.org/vote.nsf/e9e05f9ef74d8c7f05256705006e0a60/20f8a43e421379938525720a005e0b04/$FILE/A%20RES%2061%2074.pdf)>
- UNSG (United Nations Secretary-General). 2000. *Report of the Secretary-General: Methods of Destruction of Small Arms, Light Weapons, Ammunition and Explosives*. S/2000/1092 of 15 nëntor. <<http://www.un-casa.org/CASAUUpload/ELibrary/S-2000-1092.pdf>>
- USDoS (United States Department of State). 2007. *Technical Agreement Contract between the United States Department of State and the Ministry of Defence of Montenegro: The Destruction of Small Arms Weapons and Various Types of Ammunition*. Podgorica: USDoS dhe Ministria e Mbrojtjes e Malit të Zi. 3 dhjetor.
- WA (Wassenaar Arrangement). 2010. Export Control for Conventional Arms and Dual-Use Goods and Technologies. Vjenë: Wassenaar Arrangement Sekretariati. Janar. <<http://www.wassenaar.org/publicdocuments/2010/docs/WA-DOC%20%2810%29%20001%20-%20Basic%20Documents%20-%20January.pdf>>
- Wilkinson, Adrian. 2006. 'The Three Ds: Disposal, Demilitarization, and Destruction of Ammunition.' Në Stéphanie Pézard dhe Holger Anders, eds. *Targeting Ammunition: A Primer*. Gjenevë: Small Arms Survey, f. 261–91.

Lidhur me Sondazhin për Armët e Vogla

Sondazhi për Armët e Vogla shërben si burimi kryesor ndërkombëtar për publikun lidhur me aspektet e armëve të vogla dhe dhunës me armë, dhe si një qendër burimore për qeveritë, politikëbërësit, studiuesit, dhe aktivistët. Sondazhi i përcjell gjetjet e tij përmes Raporteve të Veçanta, Librave ne Seri dhe botimit të tij kryesor të përvitshëm, që është *Sondazhi për Armët e Vogla*.

Projekti ka një staf ndërkombëtar me përvojë në studimet për çështje të sigurisë, shkencat politike, politikat publike ndërkombëtare, drejtësi, ekonomi, studimet për zhvillimin, zgjidhjen e konflikteve, sociologji dhe kriminologji, dhe punon ngushtë me një rrjet botëror studiuesish dhe partnerësh.

Sondazhi për Armët e vogla është një projekt i Institutit për Studime Ndërkombëtare dhe Zhvillim në Gjenevë. Për më shumë informacion shihni www.smallarmssurvey.org.

Mbi Qasjen Rajonale ndaj Nismës për Reduktimin e Rezervave të Tepërta

Qasja Rajonale për reduktimin e Rezervave të Tepërta është një qasje rajonale afatgjatë dhe e bashkërenduar për trajtimin e rreziqeve që vijnë nga rezervat e tepërta, të paqëndrueshme, të siguruara në mënyra të papërshtatshme, apo siç njihen ndryshe si rezerva në rrezik të armëve dhe municioneve konvencionale.

Kjo qasje inkurajon qeveritë që kanë teprica të tilla dhe organizatat përkatëse që të hartojnë një qasje rajonale

proaktive dhe të bashkërenduar për të siguruar dhe për të eliminuar armët e vogla dhe të lehta, duke ngritur kapacitete lokale, duke përfituar nga praktikat më të mira dhe nga mësimet e nxjerra dhe duke koordinuar burimet në mënyrë që efikasiteti i tyre të jetë sa më i lartë.

Synimi përfundimtar i kësaj nisme është të parandalojë shpërthimet katastrofike apo diversionet e pastabilizuara të armëve dhe municioneve konvencionale.

Për më shumë informacion shih www.rasrinitiative.org.

Kreditë

Autor: Jasna Lazarevic

Redaktor: Tania Inowlocki

Korrektor: Donald Strachan

Grafika dhe faqosja: Richard Jones
(rick@studioexile.com)

Hartograf: Jillian Luff, MAPgrafix

Kontakt

Small Arms Survey
47 Avenue Blanc
1202 Geneva
Switzerland

t +41 22 908 5777

f +41 22 732 2738

